



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 11.12.2019, ora 14.00

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Shpallja dhe fillimi i procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Miratimi i kalendarit të intervistave me kandidatët e lejuar për kandidim në vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

3. Miratimi i ekspertëve të gjuhëve të huaja në funksion të realizimit të intervistave me kandidatët e lejuar për kandidim.

4. Relatimi për procedurën e ndjekur për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidaturave dhe zhvillimi i intervistave, sipas ligjit, me kandidatët e lejuar në vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

5. Hedhja e shortit për caktimin e anëtarit të Këshillit, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit dhe të vlerësimit të vendit vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 21.08.2019.

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Fatjona Memçaj | (anëtare) |
| 4. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 5. Eriol Roshi | (anëtar) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit
2. Enio Haxhimihali, përfaqësues i Avokatit të Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se anëtarja e Këshillit, zonja Arta Markuka njoftuar, para pak kohe se e ka të pamundur të jetë prezentë në mbledhjen e sotme për shkak të një pengese objektive që i vjen nga një problematikë familjare, e natyrës shëndetësore. Gjithsesi është kuorum për zhvillimin e mbledhjes, jemi 5 anëtarë në këtë mbledhje të sotme.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Shpallja dhe fillimi i procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Miratimi i kalendarit të intervistave me kandidatët e lejuar për kandidim në vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Miratimi i ekspertëve të gjuhëve të huaja në funksion të realizimit të intervistave me kandidatët e lejuar për kandidim.

Relatimi për procedurën e ndjekur për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidaturave dhe zhvillimi i intervistave, sipas ligjit, me kandidatët e lejuar në vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Hedhja e shortit për caktimin e anëtarit të Këshillit, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit dhe të vlerësimit të vendit vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 21.08.2019.

Sikurse kam njoftuar elektronikisht, krahas rendit të ditës, pastaj kjo është çështje ekstra, janë përcjellë edhe 19 nga procesverbalet e përmbledhur të mbledhjeve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për të pasur qëndrimet tuaja.

Ndërkohë ka edhe një njoftim, por edhe nga zoti Bledar Dervishaj kam një email, ai mund të shprehet edhe vetë se është i pranishëm, që bën me dije se ka një mospërputhje në rendin e ditës, atij që është shpallur në faqen elektronike dhe atij që është dërguar. Ata mund ta shpjegojnë edhe vetë gjithsesi, por mua më duket se në substancë është e njëjta. E vetmja gjë që nuk është, edhe mund të gaboje, por nuk besoj, është që në faqe nuk është çështja e procesverbaleve. Por unë nuk e kam gjykuar këtë si pikë rendi të ditës. Sepse ky duhet të ishte një proces, i cili duhej të realizohej rregullisht në fillim të çdo mbledhje. Për këtë arsye. Pra nuk është ky qëllimi për të mos ta bërë publike. Gjithsesi kjo është një çështje tjetër. Kjo është si një pikë ekstra, të cilën nëse doni ...

Bledar Dervishaj është edhe zhvillimi i procesit të intervistave...

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani vijon duke shpjeguar se e kam vëndosur “dhe zhvillimin”. Njëherë e kam ndarë, nuk e di, nga ana redaktoriale nuk e mbaj mend tani se si ka përfunduar. Por atë që kam publikuar në faqen elektronike në fakt po ta shikoni ka 1, 2, 4, 5 në fakt duhet të ishin 1, 2, 3, 4, 5 ku tek pika 5 është relatimi “dhe zhvillimi i intervistave”. Unë them mund ta ndajmë diskutimin. Në qoftë se mendohet që çështja e procesverbaleve kërkon më shumë kohë, pastaj se si e për sa kërkohet koha dhe se si mund të organizohet ajo që pretendohet, kjo është një çështje tjetër. Ky është një diskutim i dytë, i cili nuk ka arsye të na zërë pjesën e parë të mbledhjes. Ky është mendimi im paraprak. Pastaj mund të kalojmë dhe mund të vazhdojmë edhe me rendin e ditës për pjesën e zakonshme, rutinë të saj, ashtu siç kemi programuar. Nuk mendoj se më bëhet pengesë, tashmë, ashtu si kanë rrjedhur rrethanat, çështja e procesverbaleve. Këtu janë 19, ne jemi tek mbledhja 36 apo e 37, nuk e di sesa është numri tani. Kështu që këtu nuk është çështje që mund të pengoj zhvillimin e mbledhjes së sotme me rendin e ditës përkatës. Çfarë mendoni?

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se, për pjesën e procesverbalit nuk është se është ndonjë kontestim. Dakord, patjetër nëse do të duhej më shumë kohë dhe nuk them se mund të pengoj zhvillimin e kësaj mbledhje. Por, unë si relatores tashmë edhe besoj edhe koleget, janë vënë në dijeni për një shkresë të Avokatit të Popullit. Do të doja që edhe nga përfaqësuesi i Presidentit gjithsesi nëse ka ndonjë gjë tjetër. Ti dëgjojmë njëherë sepse ata kanë kontestime për gjithë organizimin e mbledhjes së sotme, mënyrën e njoftimit, për sa i përket afateve të rregullores. Ti dëgjojmë njëherë ata për pjesën tjetër flas, për procesverbalet nuk besoj.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani shprehet se mund të mos jemi formalë, mund ta bëjmë dhe kështu, nuk ka problem.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani i kërkon përfaqësuesit të Avokatit të Popullit që nëse nuk ka kundërshtim, të parashtrijë mendimet përpara Këshillit.

Enio Haxhimihali merr fjalën dhe parashtron se atëherë ndjesë që e dërguam në një kohë kaq të shkurtër. Por edhe ne njoftimi na erdhi pak vonë, prandaj edhe afatet ishin të kufizuara. Në njoftimin e bërë për mbledhje, ditën e Hënë, nëpërmjet amail-it, që është njoftuar institucioni ynë, kemi konstatuar, së pari që, nuk janë në ato afate që parashikohen në rregulloren e miratuar nga kjo KED e cila sigurisht në nenin 11 parashikon dhe rastet se kur nuk zbatohen rregulli i përgjithshëm, se kur ka përjashtime e raste të veçanta. Por as njoftimi i bërë në faqe dhe as njoftimi i bërë me email nga kryetari, drejtuar anëtarëve dhe institucionit tonë, nuk është thënë arsyeja, nuk është dhënë informacion për arsyen të mosrespektimit të afatit të parashikuar nga rregullorja që vetë kjo KED ka miratuar. Dhe për ne, fatkeqësisht kjo nuk është hera e parë që ka ndodhur. Nuk mund të themi gjithmonë, por në shumë raste, ky afat nuk është respektuar me argumentimin e kohës së kufizuar. Dhe sigurisht që ne jemi një nga institucionet, duke lënë mënjanë modestinë, për të adresuar maksimalisht nevojën e madhe që ka Shqipëria për krijimin e Gjykatës Kushtetuese funksionale dhe për emërimin sa më parë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në mënyrë që reforma në Drejtësi të japi frytet dhe rezultatet konkrete. Por nuk mund të pranojmë si institucion që ne të jemi në pamundësi të kryejes së detyrës apo të kryerjes së detyrës jo me kujdesin e duhur të parashikuar nga ligjvënësi, për shkakun e kohës së kufizuar. Dhe ju mund të thoni që njoftimi ka ardhur ditën e Hënë, ishte edhe një ditë. Dje ka qenë Dita Ndërkombëtare e Drejtësisë - 10 vjetori, institucioni ynë ka pasur një sërë aktiviteteve sepse mandati i institucionit tonë është mjaft i gjërë. Kemi qenë në komision parlamentar për ligjin për mediat dhe një sërë aktiviteteve të tjera që nuk dua tu ha kohën për ti përmendur të gjitha. Pra, përse i përket afatit koha ka qenë shumë e shkurtër dhe nuk na lejon ne, na ka vënë sërish në pozitë, gjatë gjithë vitit e kemi thënë, në një pozitë të vështirë që na mbingarkon. Dhe nuk dua ta përsërisë prapë por institucioni ynë nuk pati as staf shtesë, as buxhet shtesë, por ne jemi nga ata njerez që përpiqen të japim më të mirën e mundshme. Kjo është përse i përket procedurës.

Për sa i përket përmbajtjes së materialit ne, në vijimësi, kemi thënë që materialet që na dërgohen nuk janë të plota, qoftë në informacionin që na përcillet, qoftë në dokumentacion. Pra, kur themi informacionin kemi parasysh veprimet që ka ndjekur KED-ja. Dhe për të ilustruar kemi marrë vetëm një rast. Kemi marrë komunikimin të relatorëve me kryetarin e që lidhet me afatet. Për të parë nëse janë respektuar afatet apo jo? Detyra e institucionit tonë është pikërisht kjo për të parë zbatimin e ligjit nga ky organ. Kjo është detyra që na ka lënë qoftë Kushtetuta, qoftë ligji dhe për ne është e pamundur që ta realizojmë këtë detyrë që na ka lënë legjislacioni, për sa kohë që informacioni është i mangët. Dhe ne kemi vënë në dukje në vijimësi, gjatë gjithë mbledhjeve, nuk është hera e parë, por që sërish vazhdojnë të përsëriten të njëjtat problematika. Pra, ne kërkojmë

së pari të na jepet koha e parashikuar nga ligji dhe e dyta, të na vihet në dispozicion gjithë dokumentacioni i plotë.

Për sa i përket mos përputhjes ndërmjet njoftimit me email të bërë nga kryetari dhe njoftimit të botuar në faqen zyrtare në datën 10. Duke qenë se njoftimi i bërë në datën 10 mban një datë të më vonshme, pra, njoftimi me email i kryetarit ka qenë i datës 9, mungojnë 2 pika, pika 5 dhe pika 6, do të donim që të na konformojë për këto 2 pika nga pika 5 në 6, me 6 po e numërojmë ne sepse nuk ka pikë 6, por është bërë një shënim. Ndërsa pika 5 lidhet me zhvillimin e intervistave të kandidatëve sipas ligjit e cila në vlerësimin e institucionit tonë është e papërshtatshme që në të njëjtën ditë të bëhen të gjithë procedurat. Pra, të bëhet dhe shpallja e procedurës, edhe miratimi i kalendarit dhe miratimi i ekspertës dhe relatimi mbi procedurës dhe njëkohësisht dhe intervistimi i kandidatëve.

Për sa i përket pikës 6, pra miratimi i procesverbaleve të përmbledhura, jo rastësisht kemi vënë fjalën të përmbledhura, sepse materialet që janë vënë institucionit tonë, konstatojmë që nuk bëhet fjalë për procesverbalet e mbajtura nga sekretaria që qëndron pranë këtij organi, por bëhet fjalë për materialin e përmbledhur i cili duhet të nxirret për publikim. Pra, ka 2 lloj materialesh që përdoren nga organet kolegjiale, duke u nisur nga Këshilli i Ministrave dhe organe të tjera. Ka një procesverbal i cili mbahet për çdo mbledhje dhe në mbledhjen pasardhëse nënshkruhet nga të gjithë anëtarët dhe miratohet, ka edhe specifikisht nga ligji për organet e drejtësisë që ka përcaktuar që KED-ja për shkak të natyrës që ka i dhënë. Me mbledhje të mbyllura etj., boton një përmbledhje. Pra, së pari njëherë jemi të pa qartë për bazën ligjore që pse tani në Dhjetor po miratojmë, ju po miratoni procesverbalet e Janarit – Shkurtit e me radhë të gjithë vitit. Pra, cila është baza ligjore që po kryet ky veprim. Dhe e dyta, për shkak të kalimit të kohës mjaft të gjatë, pra, që nga Janari, është normale që një pjesë e gjërave mund të jenë fshirë nga kujtesa për shkak të ngarkesës që ka pasur ky vit mjaft i vrullshëm, ndaj do të kërkonim si institucion që përveç këtij procesverbali përmbledhës që na është dërguar me email, të na vihet në dispozicion ose versioni audio i këtyre i 19 mbledhjeve ose procesverbalet e plota të mbajtur nga sekretaria që kanë shërbyer si bazë për hartimin e procesverbaleve përmbledhëse që do të bëhen publike.

Kjo ishte shkresa e parë, e cila kërkojmë edhe njëherë ndjes që ju vu në dispozicion vetëm pak kohë përpara mbledhjes. Ndërsa në shkresën e dytë ne flasim në lidhje me përmbajtjen e dokumentacionit që përfshin rendi i ditës, është një material rreth 6 fletë dhe nuk dua të harxhoj kohën që ta lexoj. Por përsëri janë pak a shumë të njëjtat mangësi, problematika që kemi konstatuar edhe në mbledhjet e mëparshme. Pra, ne për sa i përket pjesës së përmbajtjes së dosjes, konstatojmë se jo i gjithë dokumentacioni na është vënë në dispozicion ç'ka na e bën të vështirë, për të mos thënë të pamundur dhënien e një mendimi shterues, të plotë, të detyrave që na ka

caktuar legjislatori. Kështu që ne, jemi sot këtu, por do të kërkonim kohë që ne të shikojmë me qetësi materialin dhe të japim mendimin e plotë të institucionit tonë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani i kërkon përfaqësuesit të Presidentit të Republikës, të parashtrorjë mendimet përpara Këshillit.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe parashtron se e kemi shkruajtur me email që e kemi dërguar. Nga 5 pika apo 4, konstatoj edhe unë që janë përmbledhur në një të vetme. Faktikisht tashti që dëgjoj përfaqësuesin e Avokatit të Popullit, a mund të kemi një vendim të këshillit për caktimin e një eksperti për intervistën në gjuhë të huaj dhe menjëherë të kalohet në zhvillimin e intervistës. Duket si proceduralisht është fiksuar eksperti dhe kandidatët po presim aty jashtë, apo jo? Kjo ishte dhe sensi i email. A është në rend dite pika 5 apo nuk është a i takon zhvillimit të intervistave me kandidatët që do të duhej të njoftoheshin nëse janë në kohë apo jo? Disa veprime procedurale paraprake të relatorit apo të sekretarisë teknike. Në lidhje me procesverbalet, miratimin e përmbajtjes së përmbledhjes së tyre, keni një shqetësim të Avokatit të Popullit, i anëtarëve të Këshillit, i përfaqësuesit të Presidentit. Këtu e shumë kohë më përpara edhe në vetë ndërtimit të aktit nënligjor, rregullores, edhe më pas kur janë zhvilluar mbledhjet. Dhe në ato akte nënligjore është miratuar që procesverbali i mbledhjes paraardhëse të miratohet në mbledhjen pasardhëse. Ka një moment 48 orë, i cili vihet në dispozicion çdo anëtar apo çdo të ftuari. Ai bën vërejtjet, nëse ka kundërshtime, njihet me materialin audio. Tashti në Dhjetor, personalisht unë kam qenë përfaqësuesi i Presidentit, a mund të kujtoj unë deklaratat e mia apo edhe të të ftuarve të tjerë, të 32 mbledhjeve? Nuk mundem, fizikisht është e pamundur. Edhe koha që do ti duhej ti jepej në dispozicion nëse do ti qëndrojmë strikt procedurës ose hajde se po zbatojmë nenin 17 e po themi që për çdo procesverbal mua do më duhet 48 orë. Dhe i bie 60 e ca kusur ditë, që i bie të kaloj përtej mandatit të këtij Këshilli. Këto shqetësime që Presidenti i ka vlerësuar se janë të një karakteri tej administrativ, e ka bërë publik. E ngrita dhe unë në këtë email. Nuk ka kohë të mjaftueshme nga e Hëna dhe sot, që unë të njihem me gjithë përmbajtjen e tyre. Më duhet pak më shumë kohë. Edhe nëse do ti hyja 4 përmbledhjeve së fjalës time, unë për 4 prej tyre kam dhënë miratim, për të qenë korrekt në Maj...

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se nuk doja ta thoja këtë, ndërsa Avokatja nuk më është përgjigjur.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe vijon të parashtrorjë se e kam dhënë për 4 mbledhje, 01 Shkurt, 08 Shkurt, 21 Janar, 28 Janar, brenda 48 orëve.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se e keni dhënë 23 Janar dhe 11 Qershor, të nesërmen, brenda 24 orëve.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe vijon të parashtrojë se nuk e di, unë them 48 orëve. Kështu që, për këtë tog procesverbalesh, nuk e kam aftësinë që të njihem me të gjitha dhe të jap mendim për të gjitha në 48 ore. Sepse sot do të prisja, po të ndiqnin rregullin, të prisja atë të datës 2 Dhjetor. Ato i mbaj mend shumë mirë se i kam thënë para 10 ditësh. Ky ka qenë shqetësimi që kam shprehur.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe sqaron se tani dy gjëra mund ti them edhe unë paraprakisht? E para njëherë për axhendën e mbledhjes së sotme, pra, shpallja, miratimi i ekspertit, miratimi i kalendarit, relatimi dhe zhvillimi i intervistës, këtë e kemi bërë edhe herën e kaluar, duhet tua kujtoj, në të njëjtën mënyrë. Vetëm se për shkak të mënyrës se si vendosem ne për atë pikëpyetje që na lindi atëherë lidhur me vakancën e Inspektorit, kemi dëgjuar, nëse ju kujtohet, kjo është lehtësisht e verifikueshme, kemi dëgjuar të paktën njërin nga kandidatët në intervistë. Pra, kemi bërë shpalljen, kemi miratuar kalendarin, kemi miratuar ekspertin, kemi bërë relatimin dhe kemi bërë dhe intervistën. Tani, nuk është se ka ndonjë gjë të misterhme këtu. Me një parashikim se mund të realizonim intervistat sot, nuk ka asnjë mëkat që ne tu kërkonim kandidatëve të na vihen në dispozicion, gjithmonë me kushtin që, nëse ne do të kemi kalendar të miratuar për të vijuar me intervistat. Nuk është se ka ndonjë paragjykim. Kështu proceduam edhe herën e kaluar. Pra unë nuk kam propozuar ndonjë zgjidhje të ndryshme nga ajo që kemi bërë edhe herën e kaluar. Unë për veten time nuk e shikoj këtë si një pengesë formale për ta realizuar.

E dyta, në lidhje me afatin 5 ditor, tani po ti hyjmë rregulloreve, kemi parashikuar që, në rast nevoje, nuk respektohet afati 5 ditor. Në këndvështrimin tim, sot jemi në datën 11, këtij Këshilli i mbaron mandati në datën 31 Dhjetor dhe ne, nga eksperiencia që kemi, me procesin që patëm me kandidaturat e tjera, e dimë që mundet të na marri kohë derisa ta mbyllim procesin brenda mandatit të këtij Këshilli. Kështu në kushtet që përfundoi, relatoria mund ta shpjegojë edhe më hollësisht, e gjithë procedura tjetër e përgatitjeve, nuk ka arsye sepse ne ta zvarrisnim këtë proces edhe unë do të thoja që nuk do të ishte me vënd që t'ja linim Këshillit të ardhshëm të bënte intervistat, ndërkohë që ky Këshill, kjo nuk është në kundërshtim me ligjin, të jemi të qartë, por do të ishte më efçente dhe më e arsyeshme ta përmbyllte vetë ky Këshill këtë proces për sa i përket intervistës, renditjes, dhe dërgimit të listës përfundimtare Kuvendit për ta marrë në shqyrtim. Pra, kjo është çështje e nevojës.

E treta, për plotësimin e dokumentacionit që thotë përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, unë shikoj që ata me të drejtën e tyre ata ngrenë të njëjtat probleme. Unë edhe nga zbardhja e procesverbaleve aktuale, e kam vënë re që e kemi diskutuar këtë gjë dhe Këshilli ka mbajtur qëndrime. Ne kemi një mospërputhje, secili në të drejtën e vet, për mënyrën se si e shikojmë plotësimin e dokumentacionit. Avokati i Popullit e kërkon të gjithë dokumentacionin, jo vetëm atë

të veprimeve procedurale. Ne praktikisht, dërgojmë pjesën dërrmuese, jo vetëm të asaj që formalisht me aktet tona e kemi detyrim, por çojmë dhe pjesën tjetër të dokumentacionit. Dhe këto debate i kemi zhvilluar edhe herë të tjera, kemi marrë dhe vendimet përkatëse. Gjithmonë procedura ka vazhduar. Edhe Avokatja e Popullit herë është shprehur me rezervën që kaq kam dhe unë për këtë mbaj qëndrim, herë ka mbajtur edhe qëndrim. Kështu është proceduar. Unë këtë po e kujtoj se kjo ka ndodhur vazhdimisht edhe tek këto procesverbalet që janë këtu.

Dhe tjetra, me të drejtë Zoti Bledar, ndoshta thotë që për të lexuar përmbledhjen e një procesverbali, përveç kohës së gjatë që ka kaluar, i duhen 48 orë. Atëherë, të nderuar, po sa kohë më duhen mua për ta bërë përmbledhjen më mundësitë që kam. Por unë nuk dua që ta kondicionoj rendin e ditës të kësaj mbledhje me analizën e problematikës që ka të bëjë me zbardhjen e procesverbaleve, me realizimin e përmbledhjes së tyre dhe bërjen e tyre publike. Nëse ju për ta lexuar doni 48 orë për një procesverbal apo disa procesverbale, mendoni sa kohë kërkon zbardhja dhe mendoni sa kohë kërkon përmbledhja e tyre. Në kushtet ekstremisht të kufizuara që ne kemi në Gjykatën e Lartë për të vepruar dhe kjo është e njohur publikisht, por edhe mund të dëshmohet lehtësisht. Por unë mendoj dhe dua ta veçoj pak diskutimin e procesverbaleve. E vetmja gjë që mund të them është që për pjesën e të ftuarve, praktikisht thëniet e tyre janë në mënyrë integrale. Megjithëse kemi rregulla që mund të përblidheshin dhe ashtu mendoj, por unë mund tua them se nuk ka as kohë fizike që ti përmbledhësh. Pjesa më e vështirë dhe që më ka marrë kohën mua me procesverbalet, sepse përmbledhjen nuk mund ta bëj administrata, është përmbledhja e qëndrimeve tona (*anëtarëve të Këshillit*), se ato duhen lexuar dhe pastaj duhen përmbledhur. Kjo ishte sa për ta ndarë me juve. Pastaj për sa i përket asaj kërkesë që të na vihen në dispozicion audio dhe procesverbali i plotë, mund të vini në Këshill, mund ta dëgjoni dhe mund ta studioni këtu, por ato materiale nuk mund të dalin që këtej. Nuk mund ta marr përsipër këtë përgjegjësi e të nxjerr diskutimet e anëtarëve dhe të miat jashtë Këshillit, për ti studiuar ju dhe për të mbajtur një qëndrim.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani fton anëtarin relatorë të vakancës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që sipas vlerësimit të saj të bëjë shpjegime dhe sqarime lidhur me problematikën e ngritur.

Margarita Buhali, në cilësinë e anëtares relatorë të vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për mënyrën e procedimit me këtë vakancë shpjegon dhe sqaron se mendoj ta lëmë në një moment më vonë diskutimin e procesverbalit dhe duke folur si relatore ndjej përgjegjësinë për të dhënë disa shpjegime Avokatit të Popullit lidhur me kërkesën me të cilën u njoha sot për sot, në datën 11.12.2019. Është e vërtetë që relacionet nuk kanë data, por kjo nuk do të thotë që ato nuk janë përpiluar dhe nuk janë kontrolluar paraprakisht si nga relatori me ndihmën e këshilltarit dhe

normalisht me komunikimin pastaj që bëhet gjithmonë me kryetarin e KED-së. Komunikimi ka qenë edhe gjatë ditëve të pushimit, orë pa orë, në çdo kohë, me qëllim që të plotësoheshin, derisa i arrit në finalizimin e tyre. Është e vërtetë që ka një afat 5 ditor, sikurse thotë Avokati i Popullit, lidhur me rregulloren që ne të gjithë bashkë e kemi miratuar. Po mos të harrojmë që kemi edhe një afat ligjor që e parashikon neni 239 i ligjit tonë nr. 115/ 2016 që thotë; “ jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i procedurës së verifikimit sipas nenit 234 deri në nenin 238, kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, thërret mbledhjen. Dhe mbledhja ka të bëjë pikërisht me vlerësimin e kriterëve profesionale, morale, renditjen dhe ne qëndrojmë të mbledhur 10 ditë. Llogaritim që mbledhja jonë e fundit, që e mbylli procedimin për gjithë kandidatët që kishim në KED ishte në datën 2. Atëherë data 3, 4, 5, llogarisim ditët e pushimit dhe afati ligjor është jo më vonë se 5 ditë. Është e vërtetë që ndoshta Avokati i Popullit nuk kishte atë kohën afatin 5 ditor që ti studionte këto materiale dhe të njihej për tu përgatitur me intervistën. Por kjo mbledhje u caktua duke pasur unë një komunikim, nuk është e thënë që ne komunikimet i kemi të gjitha me shkrim, zyrtare, sepse koordinojmë datat, punët, impenjimet tona të tjera që ne kemi dhe u pa në konsideratë ky afati tjetër ligjor. Prandaj, pikërisht për këtë arsye, u përpoqëm ndoshta që, duke pasur në konsideratë afatin ligjor dhe respektimin e këtij afati tjetër 10 ditor, ne mund të mbarojmë edhe më shpejt, nuk diskutohet, të ndodhë edhe intervista. U munduam paraprakisht që ato të bëheshin, ta studionim kalendarin dhe që mund të kishim një zhvillim të intervistave sot. Megjithatë, i takon këtij Këshilli të vendosë nëse do të vijojmë më tej me intervistat apo ashtu siç e ka ngritur Avokati i Popullit për pjesën e intervistave, duke qënë se nuk del e qartë dhe kalendari që ne kemi miratuar. Pra, miratimin e kalendarit dhe pyetjen po sot që kishte kalendari ndoshta bashkëlidhur. Ne e diskutojmë këtu jemi. Por doja të sqaroja këtë pjesë se duket sikur kemi nxituar. Ne kemi nxituar besoj që ky afati ligjor është shumë më prekluziv sesa afatet e rregulloreve. Dhe pikërisht ndahet një fazë e parë që është procesi i verifikimeve dhe tashmë është një fakt i njohur që ne e mbyllëm procesin e verifikimit të kandidaturave. Plotësuam numrin 5, janë të gjitha dhe pritej pak a shumë që brenda këtij afati 5 ditor ne të reagonim me mbledhjen. Është ajopjesa e relacionit që u përgatit për të pasur të dhëna sa më të detajuara. Megjithatë Avokati i Popullit, ka të drejtën e vet, të bëjë pyetje, ti dëgjoj në intervistë kandidatët. Kështu që në rast se ai do të kërkoj kohë për ta vlerësuar ai këtë në një datë tjetër, ne këtu jemi dhe disponojmë.

Për sa i përket shkresës tjetër, nuk e vë në diskutim, është e drejta e Avokatit të Popullit të marrë çfarëdo lloj akti, dokumentacioni. Të gjitha që janë këtu. Është e drejta e tyre ti marrin përse i përket kandidatëve që ne i lejuam tashmë kandidimin. Me sa shikoj, një pjesë e dokumentacionit ka të bëjë më shumë me vendimin tonë për lejim apo për ndalim kandidimi, megjithatë është e drejta e Avokatit të Popullit të diskutojë vendimarrjen e Këshillit për lejimin e

kandidimit të tyre për mungesa të dokumentacionit jo vetëm këtu tek ne por edhe kur të shkojnë këta kandidatë tek organi i emërtesës. Është vlerësimi i tij total nëse do ti marri, patjetër le ti marri, por kjo nuk pengon pjesën e vlerësimit dhe të pikëzimit. Por, për pjesën që ai duhet të jetë i përgatitur, ti dëgjojë kandidatët, të bëjë pyetje të drejtpërdrejta që edhe Këshilli të krijojë një ide sepse pjesa e intervistës është edhe pjesë e procedurës dhe që ne mbajmë në konsideratë për ti pikëzuar këta kandidatë, ta mbajmë në konsideratë këtë kërkesë, por të kemi në konsideratë dhe afatin tjetër 10 ditor që na vendos neni 239 pika 2, sepse të gjithë jemi dakort që aktualisht duhet të fillojmë procesin e vlerësimit, se procesin e verifikimit e kaluam. Kështu që e diskutojmë kryetar këtë pjesë dhe disponojmë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani sqaron se të mbajmë parasysh që dosjet e të 5 kandidatëve janë dërguar pranë Avokatit të Popullit në datën 22 Nëntor.

Vijojmë me diskutimet nga anëtarët e Këshillit.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë mbi problematikat e ngritura dhe u dakordësuan në qëndrimin se çështjen e miratimit të procesverbaleve ta ndajmë dhe ta realizojmë veçmas, duke i dhënë kohë për të pasur mundësinë për ti shqyrtuar, duke evidentuar se u relatuar që mendimet e subjekteve të ftuara janë zbardhur të plotëa shtu ashtu siç janë pa u bërë një përmbledhje. Çështjet e tjera të ngritura nga Avokati i Popullit lidhur me relacionet dhe dokumentacionin janë të përsëritura edhe më parë dhe Këshilli ka dhënë përgjigje.

Lidhur me afatin 5 ditor, ai është një afat fundor, “jo më vonë se 5 ditë”, pra është kufiri që tenton të disiplinojë KED për ecjen sa më shpejt të procedurave dhe mbledhja mund të bëhet edhe më shpejt. Nëse nuk do të njoftoheshin subjektet dhe kandidatet apo do të ishte e pamundur objektivisht të jenë të pranishëm etj., Këshilli mban qëndrim duke u përpjekur për respektimin e kontradiktorialitetit dhe për dhënien e mundësisë për të qënë efektiv në këtë procedurë. Nga ana tjetër Këshilli dëgjoj përfaqësuesin e Avokatit të Popullit të përmendë si argument se janë institucion që kanë aktivitete të ndryshme. Ky Këshill do të vijojë të punojë me ngarkesën e kërkuar, ndonëse ka në përbërje anëtarë që në mënyrë të pandërprerë janë të ngarkuar të përmbushin edhe detyrimet përkatëse në funksionet gjyqësore dhe aktivete të tjera, të cilat janë kryesore për të gjithë, ndërkohë që nuk kanë institucion dhe staf të caktuar për të trajtuar çështjet e Këshillit përveç 4 këshilltarëve të Gjykatës së Lartë. Edhe javën e mëparshme, përveç veprime të tjera, Këshilli ka zhvilluar mbledhje ndonëse ka qenë e pezulluar puna dhe veprimtaria gjyqësore. Ndonëse nuk përbën shkak për mosvijimin e mbledhjes, mund të ishte shpjeguar në njoftimin e thirrjes së saj motivi i zhvillimit në kohë më pak se 5 ditë.

Në lidhje me mënyrën e komunikimit të relatorit me kryetarin etj. Këshilli vijon të ketë qëndrimin se është e rëndësishme që komunikimet dhe veprimtaria të realizohen sipas ligjit dhe në mënyrën e tillë që të jemi sa më efektivë në zhvillimin e proceseve.

Në lidhje me propozimin e rendit të ditës për të realizuar në një ditë miratimin e ekspertit të gjuhëve të huaja, të kalendarit të intervistave dhe zhvillimit të tyre, sipas ligjit nuk është e detyrueshme që ato të zhvillohen në kohë të ndryshme. Nëse nga mbledhja do të rezultojë që ekspertët e caktuar janë në konflikt interesi me Këshillin dhe kandidatët ose nuk kanë njohuritë e duhura profesionale, Këshilli nuk e miraton dhe nuk mund të ketë kalendar dhe zhvillim të intervistave. Nëse propozohet dhe miratohet ekspert që i plotëson kriteret ligjore dhe gjykohet paraprakisht që nuk është në konflikt interesi, nuk i vjen asnjë dëm procedurës nga vijimi menjëherë me intervistat e kandidatëve të cilët njoftohen dhe japin paraprakisht pëlqimin e tyre për këtë mundësi, madje kjo e shpejton dhe sjell pasojat e duhura dhe të dëshiruara në tërësi nga këto procese.

Fakti që ka qenë i njëjti relator për vakancën e ILD, si për kandidatët e lejuar më parë dhe atyre që u paraqitën pas rishpallje së vakancës, nuk përbën problem sepse sipas ligjit dhe rregullave të KED relatori caktohet për vendin vakant dhe jo për kandidatë individualisht. Ky është një interpretim dhe qëndrim i mbajtur tashmë në raste të tjera të mëparshme nga ky Këshilli.

Për këto arsye, anëtarët e Këshillit shprehën qëndrimin se duhet të miratohet dhe të vijohet me çështjet e rendit të ditës së propozuar.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe shprehet se duket sikur u keqkuptuam. Unë nuk kërkoja 48 orë kohë. Realiteti është se po të flasim për afate, megjithëse kjo është histori e gjatë, Kushtetuta thotë që deri në Janar 2017 Inspektori duhet të ishte në detyrë. Po kjo është çështje tjetër dhe nuk i po hyj fare në atë diskutim. Kam hallin vetëm të procesverbalit. Këtë gjëndje nuk e diktoj sjellja e të ftuarve. Pra, sot po mbyllet Këshilli dhe për 20 ditë mbyllet gjithë 12 mujorëshi. Procesverbali në vlerësimin tonë është publikimi i përmbledhjes, realizon njëkohësisht, rrit transparencën, kolaudon veprimtarinë e Këshillit, nxit debatin publik. Sepse shprehen ose publikohen përmbledhja e debatit që ka ndodhur, të paktën nga të ftuarit. Edhe këtë funksion nuk e kryen tashmë. Do të ngelet tashmë proceduralisht, të zbardhen dhe të miratohen patjetër. Ky Këshill nuk duhet ta mbylli mandatin e tij pa miratuar procesverbalet. Këtë nuk e themi dot. Por si institucion i ftuar, me konteste mbi këtë proces, 48 orë që mu la të njihesha dhe ti lexoja dhe të shprehja komente duke qenë se ka 7, 8, 11 muaj që ka kaluar për disa mbledhje nuk mund të rikujtoja gjithçka. Kështu që unë e vlerësoj që në një mbledhje tjetër të Këshillit, edhe ne mund të japim mendimet tona, por kohë fizike për ti parë kush e kishte?

Anëtarët e Këshillit dakordësohen për trajtimin e procesverbaleve në mbledhje tjetër dhe të vijojë kjo mbledhje sipas çështjeve të propozuara të rendit të ditës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon Këshillin se propozon të shtohet një pikë tjetër në rendin e ditës për ta shqyrtuar nëse do të premtojë koha. Pas ardhjes në dijëni të vendit të KPK për anëtarin e Këshillit z. Fatri Islamaj, duke qenë se ai është relator i vendit vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e përkoshme shpallur nga Kuvendi, propozohet realizimi i shortit për caktimin e një relatori ndërmjet anëtarëve të Këshillit. Nga të dhënat dhe komunikimet rezultojnë që procedurat e verifikimit me kandidatët janë në pjesën fundore, atë të përfundimit të relacioneve dhe njoftimit të kandidatëve për gjetjet në procedurën e verifikimit.

Fatjona Memçaj kërkon fjalën dhe sqaron se duhet të jetë e përjashtuar nga ky short, për shkak të heqjes dorë të miratuar kohë më parë nga pjesëmarrja në procedurat e verifikimit të kandidatëve për këtë vend vakant. Prandaj, ndoshta është problemi se mbeten 4 anëtarë në hedhjen e shortit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani shpjegon shortin nuk kërkon quorum sikurse mbledhja. Anëtarët kanë të drejtë të marrin pjesë në hedhjen e shortit por nuk janë të detyruar të jenë të pranishëm. Rregullat e shortit nuk presupozojnë mbledhjen në vetvete, mund të realizohen në pjesën e mbledhjes por po të shikoni rregullat i keni që realizohet në një mënyrë tjetër. Kushdo mund të jetë i pranishëm apo jo, kur hidhet shorti. Ndërsa znj. Memçaj është vetvetiu e përjashtuar nga shortimi. Nuk ka rëndësi e bëjmë sot apo jo, por është problem që ai short duhet të zhvillohet sepse ne e kemi detyrim që të caktojmë relatorin dhe nuk mund të lëmë vakancën jetime.

Anëtarët e Këshillit vendosin të shtohet kjo si pikë e rendit të ditës dhe të zhvillohet në fund të mbledhjes në varësi të kohës së shqyrtimit të pikave të tjera të rendit të ditës.

Këshilli vijon mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se vendimarrja e parë, ashtu sikurse kemi vepruar në vakancat e tjera është ajo e vendimit formal “Për fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë”. Është vendimi që formalisht i hap rrugë procesit, mbasi ka përfunduar procedura e verifikimit dhe sipas ligjit fillon brenda 5 ditëve dhe sipas ligjit, pavarësisht se mund të ketë ankim nga kandidatët e ndaluar procesi i vlerësimit nuk ndalon. Jemi dakord ta miratojmë këtë vendim?

Anëtarët e Këshillit vendosin në mënyrë unanime miratimin e këtij vendimi.

Këshilli vijon mbledhjen me shqyrtimin e pikën tjetër të rendit të ditës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se projektendimi i dytë, është për miratimin e ekspertëve për vlerësimin e nivelit të gjuhëve të huaja. Ekspertë të miratuar për gjuhët e huaja

angleze dhe italiane kemi pasur dhe ka qenë zonja Adelina Brahimi dhe zonja Gjinali, për gjuhën Italiane. Ajo që na ndodhi, ndërkohë që po përgatisja mbledhjen ishte që zonja Albrahimi është bashkë me një grup, kam përshtypjen me një grup deputetësh ose në Bruksel ose në Strasburg dhe na njoftoj për ta zëvendësuar. Ashtu sikurse bëmë herën e kaluar, ne morëm listën e departamenteve përkatëse të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe kemi zgjedhur një person dhe në këtë rast është një pedagoge që ka një Cv 12 faqesh këtu, që është pedagoge, doktoore shkencave dhe eksperte në fakt e kësaj fushë dhe në qoftë se ju do ta miratoni, do të zëvendësojmë zonjën Albrahimi me Dr. Ogerta Stroka Koruti. Duhet të kemi parasysh se problemi i komunikimeve është edhe çështje kush është disponibël, kush e ka të drejtë ta ushtroj. Nuk është problemi që ne mund ta urdhërojmë, se ne nuk jemi gjykatë, e kemi edhe këtë veçanti apo jo? Zonja e pranoi këtë detyrë, ia përcollëm edhe udhëzimet se në çfarë bazohet, madje kemi përcjellë paraprakisht, nëse Këshilli e miraton, qënien e saj si eksperte edhe listën me emrat e kandidatëve duke i kërkuar të vlerësojë nëse ka ndonjë pengesë. Nuk dua ta detajoj ta lexoj sepse këtu është shumë i gjatë jetëshkrimi i saj, i dorëzuar prej saj dhe që gjendet dhe publik në faqen zyrtare të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës. Edhe për zonjën Albrahimi kemi vendosur në të njëjtën mënyrë

Margarita Buhali, në cilësinë e anëtares relatorë të vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, merr fjalën dhe shpjegon se që në fillimet e debatit që kemi pasur të gjithë bashku ka qenë roli i relatorit që ta caktonte paraprakisht. Unë kam qenë gjithmonë partizane e asaj që duhet të ishte roli i relatorit më i madh për ti bërë gati Këshillit ca gjëra. Gjithsesi, unë votoj për këtë eksperte. Unë nuk di që ajo të ketë një shkak për të mos u miratuar. Jam në dijeni të të gjitha masave që u morën dhe që u bënë me qëllim që të mos të dështonte mbledhja. Nuk e di nëse ka ndonjë kontestim por unë nuk kam.

Enio Haxhimihali kërkon fjalën dhe shprehet se kam një pyetje për procedurën. Nuk ka lidhje me individin por me procedurën. Juve kur prezantuat individin thatë kemi zgjedhur Kë keni parasysh kur keni zgjedhur? Keni përdorur numër shumës, domethënë administrata, ju personalisht apo?

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani shpjegon se komunikoj me kolegët. Ne komunikojmë me njëri tjetrin dhe nuk komunikojmë vetëm shkresërisht. Znj. Margarita megjithëse jeton në një vënd tjetër dhe me detyrë është në një vënd tjetër, vjen vazhdimisht këtu dhe duhet ta vlerësojmë shumë se vjen nga një vënd tjetër. Vjen në Tiranë, shikon dokumentat dhe punon. Ne e kemi këtë lloj komunikimi. Edhe unë jam bërë pjesë e procesit bashkë më të në gjetjen dhe përzgjedhjen e kandidaturave. Nuk është një gjë e lehtë për ta zgjidhur sepse ne nuk kemi kompetencën e një gjykate që të urdhërojmë dikë ta bëj këtë detyrë. Kjo është një detyrim, kjo është një detyrë që ata

e marrin nëse e pranojnë dhe në këtë proces e vetmja gjë që ne kemi bërë, ashtu siç jemi dakortësuar në parim qysh në fillim, do të marrim nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, nga listat që janë aty publike. Nuk komunikojmë më njëri me tjetrin. Aty janë të gjitha të dhënat e zonjës. Ndër to kemi propozuar këtë zonjë. Ka edhe të tjerë, por ne nuk do të sillnim 30 emra këtu për të diskutuar tani se kë do të zgjedhim nga këto 30 emra sepse është praktikisht shumë e vështirë, që ti marrim miratimin paraprak të gjithëve, ti kemi disponibël, ti njohim etj, etj. Komunikimi që unë bëj me ekspertët e propozuar është në rangun e atij që përfaqëson institucionin me të tretët. Është një propozim, është një përzgjedhje që ne bëjmë, siç bëhet në gjykata kur ka lista ekspertësh dhe është vetë gjyqtari që i vë gishtin njërit prej tyre dhe fillon komunikimi. Ne e kemi përgatitur këtë proces dhe pastaj unë bëj thjesht komunikimin përcjellës me të tretët. Kjo është e gjitha.

Margarita Buhali, në cilësinë e anëtares relatorë të vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, merr fjalën dhe shpjegon se është këtu që unë mendoj se relatori të paktën kompetencën për të bërë një propozim për një ekspert nuk ka përse mos ta ketë. Kur është ai që mundohet të përgatisi paraprakisht gjithë materialet. Duke qenë se është një fakt i njohur që unë jam më në largësi. Gjithmonë kam komunikuar me kryetarin për këtë pjesë se nuk asnjë gjë të kërkojë ekspert nga institucionet, listat dhe të reagojë me propozimin. Megjithatë këtu jemi, në qoftë se ky propozim nuk vlen kjo zonjë me këtë Cv, këshilli mund të marrë një vendim tjetër.

Enio Haxhimihali kërkon fjalën dhe shprehet këtu mungon një shkresë që thotë kush e ka propozuar dhe unë këtë po pyes. Nuk ka lidhje fare me personin. Unë po pyes si procedurë keni pasur raste të tjera kur ky organ ka propozuar ekspert, në rastin e zonjës Zhaklina Peto, në qoftë se nuk gabo, vinte propozimi nga 2 relatorët dhe thonin propozojmë ekspertët etj. Në rastin konkret, në materialet që janë shpërndarë sot mbi tavolinë nuk kanë qenë të shpërndara paraprakisht me shkresën përcjellëse është një Cv e një personi por e pa shoqëruar me relacion përkatës. Kush e ka propozuar unë këtë pyetje bëra.

Vitore Tusha, merr fjalën dhe sqaron se për këtë procedurë të ndjekur ne kemi një mendim në abstrakt më parë që e kemi shfaqur se mund të ketë njëri që mund të dinë shumë më mirë anglishten dhe kemi thënë që do të fokusohemi tek Departamenti konkret i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Ky është çështja për të cilën ne kemi rënë dakort. Brenda pedagogëve të këtij departamenti, aty do ta kërkojmë përzjedhjen e një eksperti që na nevojitet. Aq më tepër që është një fushë të cilën shumica prej jush e dini shumë shumë mirë dhe në çdo moment që keni kontestime në lidhje me komunikimin që ajo do të bëjë këtu në prani të të gjithëve mund të jetë e kritikueshme puna e saj, jo e vlerësueshme etj. Ne e dimë shumë mirë në kuptimin procedural si përdoret dhe për çfarë shërben mendimi i ekspertit.

Margarita Buhali, në cilësinë e anëtares relatorë të vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, merr fjalën dhe shpjegon se propozimin e kam bërë unë.

Anëtarët e Këshillit vendosin në mënyrë unanime miratimin e këtij vendimi dhe caktimin e Dr. Ogerta Stroka Koruti. Eshpërte për vlerësimin e nivelit të njohurive të gjuhës angleze nga kandidatët.

Këshilli vijon mbledhjen me shqyrtimin e pikës tjetër të rendit të ditës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se në lidhje me kalendarin, tani orari i sugjeruar në fakt ka kaluar, por duke shqyrtuar relacionet dhe sipas komunikimeve, kemi përcaktuar të paktën paraprakisht në bashkëbisedim me znj.Margarita, e cila mund të më korrektojë nëse gaboj, që zoti Metani dhe zonja Hysi, kanë shprehur vullnetin dhe duan të testohen në gjuhën angleze.Kandidatja Joana Asimi Sorraj, sigurisht mund ta vlerësojë edhe vetë mbledhja e Këshillit në fakt, ka studiuar në Itali dhe ideja paraprake është, por këtu do të vendoset, që nuk ka nevojë për testimin e gjuhës italiane. Megjithatë ajo ka thënë, në qoftë se ju dëshironi unë e bëj në italisht, nuk na ka thënë në anglisht. Kurse zonja Troja dhe zoti Stojani kanë shprehur vullnetin që të mos testohen në gjuhën e huaj. Për këtë arsye shikoni dhe minutazhet, se kjo është një tentativë e përafërt, nëse për dy të parët kemi thënë e përafërt 45 minuta, kemi një shkurtim në kohë në fakt për të tjerët, por që nuk se ky është obligim për tu mbyllur brenda 45 min, apo jo? Kemi thënë mund të zgjasi më pak apo më shumë por tentativa është të kemi një kalendar.

Margarita Buhali, në cilësinë e anëtares relatorë të vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, merr fjalën dhe shpjegon se jam në dijeni që të gjitha janë komunikuar, 2 nga kandidatët i nënshtrohen testin të gjuhës angleze. Vetëm tek ynj. Joana mbeti për tu parë në rast se donte apo jo bisedën në gjuhën angleze. Si ta vlerësoj Këshilli. Ka kryer shkollimin në Itali, është një fakt i njohur. Kemi një praktikë të mëparshme prandaj edhe nuk u vlerësua të testohej në italisht.

Këshilli ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër .

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Mbledhja e Këshillit, pas pushimit, vijon pikën e rendit të ditës për miratimin e kalendarit dhe zhvillimin e intervistave me kandidatët e lejuar për kandidim për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se kemi kalendarin e intervistave. Për dy kandidatet e parë, sipas komunikimeve elektronike, kanë shprehur vullnetin dhe dëshirën që të

testohen ne gjuhen angleze. Kandidatja e tretë është shprehur që nëse ju e vlerësoni të testohem ne gjuhen italiane, por ndërkohë është një kandidate që ka studiuar dhe arsimuar dhe është doktoruar ne Itali, për këtë të fundit nuk jam i sigurtë, për gjithë periudhën, prandaj ta vendosë Këshilli nëse do të testohet në gjuhën italiane, për shkak se ka deklaruar që nëse bëhet të bëhet në gjuhen Italiane. Ndërsa dy kandidatet e tjerë, znj.Troja dhe z.Stojani, kanë vendosur të mos testohen në interviste në gjuhë të huaj. Prandaj për kalendarin, tani orari ka kaluar, është 45 min për dy të parët dhe pastaj tentohet të reduktohet por kjo nuk është e detyrueshme për ne si kohëzgjatje, mundet edhe të jetë më e gjatë ose më e shkurtër intervista, në varësi te parashtrimit të kandidatit dhe të pyetjeve e përgjigjeve. Dakord me këtë kalendar ?

Anëtarët e Këshillit vendosin në mënyrë unanime miratimin e kalendarit të intervistave me kandidatët e lejuar për kandidim për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se në vijim, sipas rregullave procedurale që e kemi, është paraqitja nga relatorja, znj. Margarita, të relacioneve të cilat, gjithsesi janë ne dispozicion të secilit anëtar, të ftuarve apo Avokatit të Popullit. Pra mund të bëjmë një relativitet të përmbledhur i fakteve dhe qëllimi është për të parë që a është i përgatitur Këshilli për të kaluar në intervistë, e cila do të pasohet nga tjetër e pikëzimito. Relatorja të vlerësojë dhe mund të fillojë me radhë me relacionet e kandidatëve.

Margarita Buhali, në cilësinë e anëtares relatorë të vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, merr fjalën dhe shpjegon se mund të vepohet si ta vlerësojë Këshilli që të dëgjojmë njëherë relacionet për secilin kandidat dhe pastaj kalojmë në intervistën apo në mënyrën tjetër.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani shpjegon se mund të kujtojmë se në rregullat tona parashikohet që pas miratimit të kalendarit vijonte parashtrorja relatorja. Por, nuk është si në rastin e verifikimit që relaton në detaje. Këtu përgatitet një relacion, që i parashtrorhet të gjithëve dhe qëllimi është për të treguar se është e përgatitur situata për të kaluar në vlerësim sepse nuk do të merret ndonjë vendim a duhet të vlerësohet apo jo kandidatin.

Margarita Buhali, në cilësinë e anëtares relatorë të vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, merr fjalën dhe shpjegon se relacioni është që ta kenë në konsideratë anëtarët e Këshillit persa i përket kriterëve dhe metodologjisë që ne kemi miratuar, tek pjesa e intervistës kjo nuk ndikon dhe nuk ka lidhje me intervistën. Nëse doni të dëgjoni relacionet e pastaj te kalojmë tek intervistën, relacionet i kemi pasur te gjithë. Nëse ndonjëri nga ne ka ndonjë gjë, pyetje shtesë mund ta bëjë, por nuk e vlerësoj se patjetër duhet të relatohet tani.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se të kujtojmë se në intervistat e herës së kaluar nuk kemi dëgjuar relacionet por i kemi pasur përpara, edhe dokumentet e kemi.

Margarita Buhali, në cilësinë e anëtares relatorë të vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, merr fjalën dhe shpjegon se unë kam vetëm tju relatoj diçka për njërin nga kandidatet sepse jetëshkrimet dhe gjithë dokumentacioni ka qene paraprakisht qe ne momentin kur u diskutuar lejim dhe ndalimet sepse vjetërsia është kusht për kandidim. Vetëm për disa nga kandidatet psh. kandidatja Joana Asimi Sorraj, pas verifikimit që ajo ka parë ndoshta edhe për shkak të relacionit që ne i nisëm, ku i nisëm vjetërsinë e saj në punë duke pasur në konsideratë edhe kriteret ligjore për një vjetërsinë plote nga janari 2004 – etj, ka paraqitur një vërtetim nga Universiteti “Ismail Qemali” ku është e pasqyruar se ka filluar që nga tetori 2003- deri ne 04.01.2004 ka filluar si pedagoge jashtme dhe prandaj i shtohen edhe muajt tetor, nëntor, dhjetor. Ky është një dokument i ri që nuk është relatuar, sepse po të ishte do ta kisha rehatuar që kjo kandidate ka edhe këtë shtesë ne kuptimin e vjetërsisë saj. Kur u bë verifikimi këtë të dhënë nuk e kishim. Gjithsesi kjo ka ardhur tashmë dhe është e drejta e kandidateve ,për aq kohë sa Këshilli nuk ka dalë me vendim, për më tepër jemi në mbledhje, të sjellin dokumente shtesë në rast se ve lerësojnë. Po ashtu dhe për Z.Artur Metanin janëdërguar disa letra rekomandimi. Kanë qenë, por janë thjesht dokumentacione për efekte vlerësimi, letër rekomandimi e gjyqtarit Manguson dhe letër rekomandimi të gjyqtarit Walker.

Anëtarët e Këshillit vendosin në mënyrë unanime të vijohet me intervistat e kandidatëve.

Këshilli ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër, rreth 10 minuata për të përgatitur zhvillimin e intervistave .

PJESA E TRETË E MBLEDHJES

Mbledhja e Këshillit, pas pushimit, vijon me zhvillimin e intervistave me kandidatët e lejuar për kandidim për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se sikurse është parashikuar në vendimin normativ nr. 5/2019 të KED, përpara se të thirren kandidatët sipas kalendarit të miratuar, është thirrur dhe është paraqitur, pra në sallën e mbledhjes, znj.Ogerta Stroka Kuruti, e cila, sikurse e diskutuam paraprakisht në pjesën e parë të mbledhjes, është pedagoge e brendshme ne Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës Departamenti i Gjuhës Angleze. Sipas procedurës që ne kemi të miratuar ne cilësinë ekspertes ajo është njohur praktikisht paraprakisht me natyrën e detyrës që i kërkohet nga Këshilli dhe ligjet dhe aktet normative mbi të cilën zhvillohet. Përpara se të vazhdojmë tej do ti kërkohet ekspertes që të bëhet betimi. Mbase lexohet formula dhe ju do të thoni betohem dhe më pas procedohet me tutje. Në rregull?

Eksperte e gjuhës angleze Ogerta Stroka merr fjalën dhe shprehet në rregull.

Lexohet formula e betimit nga ana e Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Z. Ardian Dvorani.

Ogerta Stroka merr fjalën dhe shprehet “Beto hem”.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon ekspertin se në ditën sotme janë dy kandidatë të cilët kanë shprehur vullnetin për tu intervistuar në gjuhën angleze emri i të cilëve është Artur Metani, aktualisht Avokati Shtetit dhe znj. Eris Hysi e cila është avokate që na rezulton nga CV se punon në studion Haxhia & Hajdari, të cilët, në fakt me hipotezën e miratimit të qenies suaj si eksperte, ua kemi bërë të ditur më përpara: Prandaj ju kërkohet të deklaroni këtu nëse vëreni elementë konflikti interesi dhe papajtueshmërie me dy kandidatët Artur Metani dhe Eris Hysi.

Ogerta Stroka merr fjalën dhe shprehet se nuk kam konflikt interesi.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se sipas procedurës do të thirren kandidatët. I pari është kandidati Artur Metani.

Paraqitet kandidati per Inspektor i Lartë i Drejtësisë Artur Metani.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon kandidatin se sikurse ju prezumoj që e njihni ligjin dhe rregullat që zbatohen në këtë procedurë verifikimi, vlerësimi dhe renditje të kandidatëve, mbas këtyre të gjitha veprimeve të tjera të kryera paraprakisht, kemi dhe veprimin e intervistës në ditën e sotme. Përpara se të vijojmë dhe të japim një orientim të mëtejshëm për natyrën e intervistës dhe ndonjë udhëzim paraprak, ju kërkohet të vëreni në sallë ose të paktën dhe në dijeninë tuaj nëse keni konstatuar apo konstatojnë gjendje papajtueshmërie dhe konflikti interesi me anëtarët e KED, të cilët i njihni publikisht, me pedagogen Orgerta Stroka Kuruti e cila është këtu në cilësinë e ekspertes për të ndihmuar Këshillin për nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja nga ana juaj. Edhe pse nuk janë anëtarë të Këshillit, por janë vëzhgues, ne e kemi vlerësuar në rregullat tona që mund të shpreheni edhe nëse kemi të njëjtën gjendje konflikti interesi me Z. Bledar Dervishi këshilltar i Presidentit të Republikës dhe me z Enio Haxhimihali, përfaqësues i Avokatit të Popullit .

Kandidati Artur Metani merr fjalën dhe shprehet se në kuptim të ligjit, nuk kam asnjë konflikt interesi me asnjë nga anëtarët apo me të ftuarit e tjerë pjesëmarrës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon kandidatin se veprimi i intervistës është pak a shumë i organizuar në mënyrë të tillë. Ju keni paraqitur një motivim me shkrim, një platformë, të cilën ne e kemi pasur në dispozicion të gjithë, Në pjesën e parë të intervistës ju kërkohet që në mënyrë të përmbledhur, për aq sa ju e vlerësoni, të parashtroni para Këshillit motivimin e kandidimit tuaj, platformën, vizionin tuaj për këtë institucion të ri kushtetues shumë të rëndësishëm në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Pas kësaj secili nga anëtarët e Këshillit mund

të ushtrojë të drejtën e tij për tju drejtuar pyetje, të cilave ju mund të vlerësoni për tju përgjigjur apo jo. Dhe mbasi mbaron kjo pjesë, në pjesën e fundit të intervistës do ketë një bashkëbisedim mes jush dhe profesoreshës Ogerta që është këtu, në gjuhën e huaj. Ne i kemi pyetur paraprakisht të gjithë kandidatët nëse e dëshirojnë sepse kjo nuk është një detyrim dhe ju e keni shprehur vullnetin për të zhvilluar edhe këtë pjesë të procesit cila është edhe pjesa fundore e intervistës. Ne e kemi në dispozicion motivimin me shkrim, por për ato gjëra që i mendoni si më të rëndësishme aty, mund ti nënvizoni, duke administruar edhe kohën. Mund të filloni me parashtrimin tuaj. Mund ta mbani pak me afër mikrofonin se krijohet problem me zbardhjen.

Kandidati Artur Metani merr fjalën dhe parashtron përmbledhjen e platformës së paraqitur me shkrim, e cila bëhet pjese e dosjes së kandidatit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se është pjesa që anëtarët e Këshillit i drejtojnë pyetje ose kërkojnë shpjegime për çështje të caktuara. Një pyetje do ta kisha që në fillim. Ky është institucion i ri kushtetues që nuk ka ekzistuar më parë dhe sikurse besoj ju e dini pas zgjedhjes së tij, ky është edhe një institucion, nuk është thjesht një organ monokratik. Si e shikoni ju dhe kush janë sfidat e natyrës legjislative, organizative, administrative me të cilat ju do të përballeni dhe kush janë prioritare deri në ngritjen e institucionit në tërësi? Pra nëse ju do ishit ILD kjo gjë sigurisht, siç e dini ,nuk do të mjaftonte sepse kërkojmë edhe që institucioni të jetë funksional. Dhe e dyta, e lidhur me këtë, nuk jam i njohur në detaje, por vura re në media se ka dhe një nismë nga Kuvendi për ti dhënë në mënyrë kalimtare, përkohësisht ,kompetenca të natyrës të inspektimit KLGj-së dhe KLP-së ,nuk njoh këtë në detaje, por si e shikoni ju, këtë nisem dhe a ndihmon kjo apo jo procesin? Mund të mos i përgjigjeni por kjo është një pyetje që më lindi mua.

Kandidati Artur Metani merr fjalën dhe përgjigjet patjetër kryetar. Kjo është një tryeze shkëmbimi mendimesh dhe jo thjesht një intervistë në këndvështrimin tim. Iniciativën që u përmend dhe e kam parë edhe unë, e kam parë në gazetë. Nuk do doja ti jap vlerësimin, është e drejte apo e padrejte kjo nisme, por unë mendoj se i shërben institucionit sepse të paktën i jep një kohë frymëmarrje për ngritjen dhe konsolidimin e proceseve, se paku. Është një institucion që po ngrihet nga e para, po flasim nga e para, që nga protokollit dhe nga letra, koka e letrës, vulat, lë pastaj për sfidat që ka procesi vetë dhe i ngritja e institucionit. Se dyti është procesi që duhet orientuar drejt rekrutimit të njerëzve, të stafit, pra inspektoreve dhe vlerësimi i atyre që janë në detyrë sot në dijëni time dhe KLGj po bën një vlerësim të inspektoreve që janë sot, për shkak ndoshta edhe të kësaj nismë të re e do të jenë pjesë e KLGJ e cila do kalojë në ILD. Kjo duhet parë sigurisht, edhe për këtë desha të falënderoj KED, për punën që ka bërë në ngritjen e infrastrukturës së tij nënligjore për rekrutimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kjo gjë që

natyrisht reflektohet edhe ne procedurat e rekrutimit te inspektoreve duke u thjeshtuar shume edhe puna qe ka bere KED-ja, por edhe puna qe ka bere KLGj dhe punen qe po e ben KLP per miratimin e akteve te reja. Dhe sigurisht ketu vjen inspektori me nje fare lehtesie sepse aktet pergjithesisht jane te ngritura. Do te shtoja ketu edhe aktet qe ka pergatitur EURALIUS, pra "Manualin e Inspektimit te Gjyqtareve dhe Prokurorit" dhe te gjitha keto jane ato qe mund te mos perbejne bazen ose themelin punes se Inspektorit, por perbejne baze per te filluar me diskutimin dhe per te filluar nje pune jo nga e para. Sigurisht edhe sipas ligjit, ILD duhet te marri dhe duhet te transferojte te gjithë arkivat e ankesave qe KLGJ-ja ka sot dhe arkiva e ankesave qe vazhdojne ne vijne KLGj-së, me sa di është një numër i madh 300-400 ankesa. Sigurisht është një proces i rëndësishëm pune qe duhet evaduar dhe evidentuar në pergjithësi por dhe shpejt. Të gjitha këto janë procese qe do kryhen dhe ne kuadër te dispozitave kalimtare qe ligji e ka parashikuar, për marrjen e inspektoreve nga rrethi i magistratëve. Ajo mund te jete një proces edhe me i thjeshtuar se sa marrja e inspektoreve nga ato qe janë juriste në fushat e tyre. E gjykoj qe procesi i marrjes në pune si inspektoreve si njerëz qe vijnë nga fusha jomagjistrat do jete më e vështire, mund te zgjas në kohë. Megjithatë këto janë procese qe duhen pare ne vijimësi .

Mbledhjes i bashkohet Avokatja e Popullit Erinda Ballanca.

Margarita Buhali merr fjalën dhe duke e falënderuar dhe uruar sukses për kandidimin, shprehet se doja tju bëja disa pyetje duke e pasur në konsideratë faktin qe ju tashme keni një eksperience menaxhimi të institucionit të Avokatit të Shtetit. Përsa i përket mënyrës se organizimit qe ju keni zgjedhur ne këtë institucion dhe rekrutimeve të reja qe keni bere ne këtë institucion gjatë periudhës tuaj. Ideja e pyetjes qëndron në faktin se unë jam gjyqtare e apelit dhe ne jemi gjithmonë në kontakt me përfaqësuesit e Avokatit së Shtetit për shkak se janë të pranishëm sidomos në çështjet me ankime në adresë të inspektimit të pronave dhe kemi konstatuar se janë marre, janë bere rekrutime dhe duke qenë se pjesë e organizimit të punës se një inspektorati qe do të ngrihet rishtazi si institucion është edhe mënyra e rekrutimit, do të doja të dija eksperiencën tuaj se si e keni bere për avokatët, gjithmonë ne qofte se e keni bere për avokatet e rinj të shtetit qe janë marrë gjate periudhës se mandatit tuaj.

Kandidati Artur Metani merr fjalën dhe pergjigjet se po kam bere rekrutime sepse unë fillova punë menjëherë në një kohe qe u miratuan dhe ndryshimet e ligjit të Avokaturës se Shtetit qe ishin ndryshime thelbësore si përsa i përket funksioneve qe ka Avokatia e Shtetit sot por ajo me themelore është edhe pjesa e pagave në institucionin e avokaturës se shtetit. Pagat u rriten gati 2 fish, mos ndoshta me shume dhe kjo ishte një gjë shumë e mire sepse mendonin se do të vinin një grup avokatësh. Por sigurisht edhe një pergjegjësi e madhe pasi edhe presioni ishte shume i lartë. Ajo qe më krijoi besim te vetja ishte procesi i një konkurrimi super të paanshëm të

organizuar me Fakultetin e Drejtësisë edhe me Shkollën e Magjistraturës. U përpoqa të ndjek të gjithë procesin që ndjek Shkolla e Magjistraturës në rekrutimin magjistratëve të rinj. U mundova ti përtafrohesh aq sa mundesha duke pasë parasysh natyrën ligjit. Duke pasur parasysh stafin e Shkollës së Magjistraturës, bëra një përmbledhje të eksperiencave të grupeve me të mira të pedagoqeve por edhe të stafit të shkollës së magjistraturës por edhe të avokatisë sepse jo të gjithë avokatet hynë në testim dhe rezultoi që prurjet që i erdhën në institucionit janë përgjithësisht të mira në këndvështrimin tim, mendoj se kanë sjelle diferencë dhe në trajtimin dhe mbrojtjen që bëjnë para gjykatave. Kjo është perceptim që vjen dhe nga gjykatat e tjera, meqë ju punoni në Vlorë. Vlorë ka qenë në fakt zyrë me probleme në këndvështrimin tim sepse edhe natyra e problemeve është më e mprehtë atje. Sigurisht duke qenë dhe më mprehtë ka dhe shumë interesa, ka dhe shumë fjalë dhe vepra. Në atë periudhë që zyrë e Vlorës gati u përgjysmua me atë konkurrencë, dërguam tre avokatë nga Tirana për të përballuar çështjet me pronat dhe në marrëdhënie me ATP. Besoj që kanë bërë një punë të mirë dhe avokatet atje. Zyrë e Vlorës po merr frymëmarrje sepse janë angazhuar 3-4 avokate të rinj. Është e vështirë sepse nuk është se rrethet prodhojmë këndvështrimin tim shumë juriste dhe juriste të mirë. Duke pasur parasysh kushtet dhe për shkak të që kemi bërë, besoj që kam arritur në një nivel të kënaqshëm të stafit tim.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se ka një pyetje tjetër. Ju e prezantuat platformën tuaj dhe rezultoi që jeni një njohës i mirë, të paktën për sa i përket mënyrës së organizimit, por duke qenë se përfaqësoj edhe një pjesë të mirë të kolegëve, doja të dija diçka më shumë mbi eksperiencën tuaj procedurale, për dy ligjet procedurale, flas për aspektin penal. Unë e kam parë cv-në tuaj, keni qenë pjesë e këshillit të prokurorisë. Normalisht duke qenë drejtues i Avokaturës së Shtetit që merret më shumë me aspektet procedurale civile, ndoshta është pjesë e praktikës tuaj edhe verifikimi i raportimit ju bëjnë avokatet e shtetit në çështjet e caktuar në aspektin procedural. Doja të dija diçka personale që ju ta ndani lidhur me eksperiencat procedurale të dy ligjeve bazë, që operojnë gjykata, që është procedura penale për prokurorinë dhe procedura civile për pjesën e gjyqësorit.

Kandidati Artur Metani merr fjalën dhe përgjigjet se për sa i përket eksperiencës sime sigurisht që është e kufizuar në përfaqësimin në gjykata. Unë kam përfaqësuar institucionin e Presidentit të Republikës shpesh në Gjykatën Kushtetuese, shumë rrallë në gjykatat e rrethit. Përfaqësoj ose kam pasë disa raste të përfaqësoj Shqipërinë në Gjykatën e Strasburgut, jo në seancë plenare, por përmes mbrojtjes që unë çoj dhe në dy raste kam pasur çështjet e arbitrazhit. Unë mendoj që roli i inspektorit duhet të jetë i shumanshëm. E shoh jo vetëm si ushtrues të procedimit disiplinor që është një nga kompetencat kryesore, por sigurisht edhe të menaxhimit të procesit të procedimit disiplinor. Roli i inspektorit nëpërmjet udhëzimit që ndjek, orientimit që jep

inspektoriëve sigurisht i jep më shumë përparësi rolit të tij menaxhues në këtë institucion. Kjo është ajo që vlerësova në përgjigje të pyetjes suaj. Drepëdrejtë nuk është se kam eksperience konkrete përfaqësimi në gjykata.

Vitore Tusha merr fjalën dhe shprehet se nisur nga cv-ja juaj dhe nga aktivitetit juaj prej kaq vitesh, keni një njohje të mire sa i takon gjyqësorit, por nga lart duke qene këshilltar i disa presidenteve ju keni patur mundësi të dini problematikat e çështjet që ka trajtuar. Ne këtë drejtim nuk kam ndonjë pyetje sepse do të kalonte përtej. Çështje e njohjes se drejtësisë është një çështje shumë e rëndësishme për këtë pozicion që ju konkurrioni. Por drejtësisë në tërësi përveçse ligjeve edhe burimeve njerëzore e mënyrës se si funksionon, po kaq e rëndësishme është dhe çështja e të qenurit një menaxher i mirë, për shkak të kompetencës që ka ky institucion. Pyetja ime do fokusohet kryesisht në eksperiencën tuaj. Ju keni disa eksperiencë edhe në drejtim të menaxhimit dhe megjithëse është një periudhë e shkurtër 1 vjeçare që ju jeni në krye të Avokatit të Shtetit, çfarë do të veçonit ju që ka sjellë ndryshe prania juaj. Pra çfarë performancë i keni ndryshuar këtij institucioni, në sy të publikut apo dhe në sy të institucioneve, të gjykatës, të qytetareve002C pra çfarë keni bërë ndryshe ju ?

Kandidati Artur Metani merr fjalën dhe përgjigjet se në fakt për hir të saktësisë kam pasur dhe një eksperiencë tjetër menaxhuese përveç të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, sepse duke qënë drejtor në Kryeministri, stafi dhe grupi i drejtorisë që drejtoja shkonte në 30 veta. Kështu që edhe aty kam nxjerrë akte apo kam ndihmuar, kam nxjerre punime që kanë reformuar sistemin e asaj drejtorie ku unë punoja. Këtu doja të nxjerr, ndoshta Z. Dvorani e njeh punën e vlerësimit paraprak të akteve, personalisht kam bërë një metodologji se si aktet e qeverisë duhet të kenë një vlerësim paraprak financiar, burimeve njerëzore etj. gjë që mungonte deri para dy vitesh kur u miratua kjo reforme me vendim të Këshillit të Ministrave dhe sot kuadri nënligjor, në dijeninë time, kalon nëpërmjet këtyre e filtrave. E thashë për të treguar që në punën që kam qënë jam mundur të nxjerr, të bëj një reforme brenda atyre kompetencave që më caktonte ligji. Sa i përket punës avokatit të shtetit, puna e parë që bëra ishte ngritja e gjithë infrastrukturës nënligjore në zbatim të ndryshimeve ligjore që pësoi ligji në dhjetor të vitit të kaluar, që nga aktet që rregullojnë apo vlerësonin apo bënin metodologjinë e vlerësimit të punës së avokatit të shtetit, aktet që rregullonin kontraktimin e firmave ligjore ndërkombëtare për rastet kur Shqipëria ishte në çështje arbitrazhi, kam bërë aktet apo udhëzimet e ndryshme që ka nxjerr Avokati i Shtetit që nuk janë publike, përveç rregullores që është publike.

Jam mundur të ngre profesionalisht të gjithë avokatet e shtetit nëpërmjet një projekti të Këshillit të Evropës. Kemi bërë trajnime disa trajnime brenda një viti po them 3- 4 për çështje të caktuara që i intereson avokaturës së shtetit në mënyrë të veçantë për çështje të trajtimit të ligjit

të pronave mbas përfundimit të misionit të Agjencisë së Kthimit të Pronave. Është një sfidë në fakt që unë mendoj që nuk mbaron me kaq, sigurisht vetëm me trajnimin e avokatit të shtetit por duhet edhe gjetja e gjuhës së përbashkët mes avokatit të shtetit dhe gjyqtareve jo në dëm të palës, por për të kuptuar logjikën e ligjit dhe vendimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës i dha një vullë këtij ligji. Në jemi dhe po presim në fakt vendimin e Gjykatës Evropiane për ndryshimin e ligjit. Po kuptimi i ligjit nga të gjithë në mënyrë uniforme do ishte gjeja më e mirë sepse ndryshe kuptohet në Vlorë, ndryshe kuptohet në Shkodër, ndryshe kuptohet në Tiranë. Megjithatë kjo është një nga sfidat që ka shteti dhe Avokatura e Shtetit. Tjetër gjë në këndvështrimin tim ka ndihmuar punën e avokatit të shtetit është kontakti direkti titullarit me avokatin e shtetit sepse çdo avokat i shtetit ka nevojë të konsultohet për çështje të veçanta, për çdo gjë. Tjetër gjë është edhe ringritja e institucioneve brenda avokati i shtetit apo organizmave brenda avokatit i shtetit që garantojnë pavarësinë e avokatit të shtetit edhe dinjitetin e avokatit të shtetit po dhe funksionin e avokatit të shtetit, siç është Kolegji Avokateve, Kolegji Inspektorit, Mbledhje Këshillit Konsultativ që Avokati i Shtetit, pra të gjitha shkojnë drejt një qëllimi dikush me shpejt dikush me avash sepse e tillë është natyra por e gjitha të shkonte drejt qëllimit, drejt funksionimit në mënyrë sa më të përgjegjshme të Avokati i Shtetit dhe besoj që është arritur disi sepse nga perceptimi që marrim nga avokatet, por edhe nga gjyqtaret siç e thashë ka një ndryshim me trend pozitiv.

Eriol Roshi merr fjalën dhe shprehet se ju uroj për kandidaturën tuaj. Si gjyqtar i shkallës së parë mbase duhet të jem pak më konkret. Si mendoni, si do ta zgjidhni çështjen, mbasi siç e kuptoj unë perceptimin, për ankesat e bëra nga Avokati i Shtetit në vite për gjyqtaret e ndryshëm. Si do ta shmangni në sytë të tyre perceptimin e konfliktit të interesit edhe në kuptim formal. Pra drejtoni aktualisht një institucion, i cili lidhet së pari me veprimtarinë gjykatave dhe ndër vite ka ankesa, me të drejtë apo jo nuk po e vë në dyshim, nga avokatura e shtetit për gjyqtarët. Ju eventualisht nëse do të zgjidhni Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, si do ta shmangni perceptimin në sytë të gjyqtareve për konfliktin e interesit edhe në kuptimin formal, nuk e di a jam i qartë?

Kandidati Artur Metani merr fjalën dhe përgjigjet se ajo që do të thoja është që Kushtetuta dhe ligji kanë parashikuar të gjitha kompetencat që ka ILD e në mënyrë të detajuar. Ajo që ngelet nuk është se ka ndonjë problematike të parregulluar në ligj që do të ngelet Inspektorit për ta vendosur. Sigurisht fryma që jep ILD ka shumë rëndësi për mënyrën e zbatimit të kompetencave të veta. Unë kudo ku kam punuar kam dhënë ose jam përpjekur të jap perceptimin se jam i paanshëm, jam rigoroz sa i përket zbatimit të ligjit, madje kam pasur probleme kundërshtimit tim për çështje të caktuara dhe nuk besoj se do të nënshtrohem ndonjëherë

emocionit as për avokaturën e shtetit, as për institucionet ku kam punuar me parë, as emocioneve që mund të vijnë nga çështje të caktuar të publikut apo lobe interesi. Për mua rendësi ka që ILD të jetë bashkëpunues dhe të jetë nxitës i rritjes së performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Eriol Roshi merr fjalën dhe shprehet se ka edhe një pyetje. Në praktike nga puna që kam si drejtues gjykate, duket sikur KPK organi i rivlerësimit merr në shqyrtim ankesat edhe për anën profesionale të gjyqtareve, në një kohë që do të krijohet edhe ILD. A mendoni se krijohet mbivendosje mes këtyre dy institucione dhe në rast se po, ka mënyra ligjore për shmangien e kësaj mbivendosje?

Kandidati Artur Metani merr fjalën dhe përgjigjet se nuk mendoj se ka mbivendosje mbi punën. Kompetencat janë të ndara, është shumë mirë që ngrihet ky institucion tashmë sepse sigurisht është një institucion i përhershëm dhe jo i përkohshëm në ndryshim nga organet e vetingut. Unë i gjykoj që funksionet janë të ndara dhe kompetencat i kanë të ndara dhe unë e shoh bashkëpunim me të fortë të ILD me KLGJ, KLP, edhe organet e tjera dhe me këshillat e gjykatave apo dhe me institucionet e tjera siç është Ministria e Drejtësisë, institucione që kanë lidhje me punën që bën inspektori, me Ministrinë e Brendshme, Presidencën e kështu me radhë.

Fatjona Memçaj merr fjalën dhe duke e falënderuar për pjesëmarrjen dhe kandidimit shprehet se kam një pyetje. Keni një eksperiencë shumë të gjerë si këshilltar juridike i Presidentit të Republikës, i cili ka qene edhe kryetari i KLD-së dhe për aq sa e njoh unë këtë institucion, këshilltari juridik kanë qenë pika e lidhjes mes Institucionit të Presidentit, KLD-së dhe Inspektoratit të Drejtësisë. Nëse mund të na thoni diçka më shumë nga përvoja që ju keni përfituar gjatë ushtrimit të kësaj kompetence të Presidentit ku impakti i këshilltarit ka qenë, e dimë dhe e njoh atë institucion mirë, e di që ka qenë i ndjeshëm.

Kandidati Artur Metani merr fjalën dhe përgjigjet se natyra e punës së këshilltarit juridik të Presidentit për këtë çështje ishte që për çdo mbledhje të KLD-së përgatiste natyrisht materialet përmbledhëse dhe dosjen e plote për çdo pikë të rendit të ditës së KLD që përgjithësisht ishin masa, të propozuara nga ministri i drejtësisë ndaj gjyqtareve. Dhe sigurisht të përgatisje një dosje të tillë për Presidentin e RSH i cili do të bazohej tek kjo dosje për vendimmarrjen e tij të mëtejshme, ishte një përgjegjësi shumë e madhe sepse një fjalë e gabuar, një vendimmarrje e gabuar, jo vetëm personalisht ishte padyshim e rëndë por edhe për Presidentin edhe për sistemin. Në këtë kuptim kjo kërkonte që të lexohet me vëmendje çdo dispozitë ligjore apo ku bazohej pretendimi i Ministrit apo për çdo çështje tjetër. Sigurisht kjo të jep eksperiencë se duke i prekur me dorë është eksperiencë për çështje që ka trajtuar KLD. Fati im i mirë ka qenë se kam punuar për vite dhe e kam bërë këtë punë për vite dhe kjo më ka bërë të njoh edhe çështje konkrete për mënyrën si i drejtohet Ministrit të Drejtësisë apo si operon KLD për këto lloj çështjes dhe

vendimmarrjet e tij dhe sigurisht edhe eksperiencat e tjera, ndoshta dhe pa kuptuar vijën e dalin gjatë ngritjes në detyra apo gjatë rritjes profesionalisht te njeriut.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani pasi vëren se nuk ka pyetje te tjera, orienton vijimin e intervistës, në pjesën e dytë të saj, lidhur me vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhës angleze, me ekspertin që është e pranishme dhe do të jetë ajo që do të zhvillojë bisedën për atë që vlerëson të arsyeshme.

Ekspertja Dr.Ogerta Stroka Koruti zhvillon bisedën e lirë dhe me pyetje përgjigje me kandidatin Artur Metani në gjuhën angleze (kohazgjatja e kësaj pjese të intervistës rreth 5 minuta)

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani pasi përfundimit të bisedës në gjuhën angleze shprehet se kjo është pjesa e fundit e intervistës me kandidatin Artur Metani. Duke ju uruar suksese mund të largoheni. Mund të njoftohet kandidati tjetër.

Paraqitet kandidatja per Inspektor i Lartë i Drejtësisë Eris Hysi.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani duke i uruar mbarësi dhe sukses e informon kandidatin se sikurse e prezumoj, ju jeni në dijeni të ligjit. Kjo interviste është pjesë e veprimeve që KED zhvillon me kandidatet në kuadër të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së tyre në vendin vakant ku edhe ju keni aplikuar. Në këtë kontekst realizohet kjo interviste dhe përpara se tju jap 2-3 orientime të thjeshta për mënyrën se si procedohet gjatë intervistës, duke qenë se ju jeni të njohur edhe me aktet, në këtë aspekt, do të kërkoja, ju njihni përbërjen e Këshillit, znj Erinda e njihni besoj dhe është edhe znj. Ogerta Stroka Kuruti pedagoge e brendshme e gjuhëve të huaja nga Departamenti i Gjuhës Angleze që është këtu për pjesën e dytë të intervistës. Do tju kërkoja duke njohur personat që janë të pranishme në interviste a keni ndonjë konflikt interesi apo situatë papajtueshmërie?

Kandidati Eris Hysi merr fjalën dhe përgjigjet se nuk shoh asnjë mundësi konflikti interesi me personat që janë të pranishëm.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani e informon kandidaten se intervista është njësoj e strukturuar për ju të gjithë. Pjesa e parë është parashtrimi i lire nga ana juaj në një kohë të arsyeshme që mund ta vlerësoni edhe vetë. Duke pasur parasysh veprimtarinë e Këshillit ju do keni kohën e nevojshme që të argumentoni por edhe të vlerësoni atë që është më e rëndësishme për parashtrimin mbi motivimin, platformën dhe vizionin tuaj lidhur me ILD. Me sa di unë, keni bërë një motivim me shkrim dhe e keni depozituar. Në e kemi në dispozicion atë dhe nuk është e nevojshme mendoj unë të lexohet e gjitha. Mbas këtij parashtrimi, eventualisht anëtarët e Këshillit ju drejtojnë pyetje të cilat ju i vlerësoni vete te jepni përgjigje apo jo. Pastaj pjesa e fundit është një komunikim midis jush edhe Dr.Ogertes në gjuhën angleze me të cilën Këshilli krijon një

mendim lidhur me njohurinë e gjuhëve të huaja nga ana juaj dhe ju e keni pranuar për tju nënshtruar edhe këtij ushtrimi. Kështu që mund të filloni me pjesën e parë me parashtrimin tuaj të përgjithshëm.

Kandidati Eris Hysi merr fjalën dhe parashtron përmbledhjen e platformës së paraqitur me shkrim, e cila bëhet pjese e dosjes së kandidatit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon kandidatin se në vijim do të ketë pyetje nga ana e anëtarëve të Këshillit. Unë do të bëj të njëjtën pyetje, për afërsisht atë që i bëra dhe kandidatit të mëparshëm. Ju i ceket në fak. Një nga problematikat që do të ndesheshit ju nesër, nese do të zgjidheshit nga Kuvendi, është krijimi i institucionit, sepse Inspektori është funksionari kushtetues por kemi edhe institucion, të cilin, ju e shpjeguat nga këndvështrimi juaj. Është një çështje shumë e elaboruar në fakt, si e mendoni sa kohë mendoni se mund tju marrë ky proces ? E dyta si e mendoni, pra si do ti qasemi këtij procesi sepse duhet të krijohet në një kohë sa më shpejt të mundshme por duhet ruajtur edhe integriteti dhe profesionalizmi, gjithsesi sa kohë mendoni? Dua të di si e qasni efektin e kohës, ku do të mbështeteni dhe si e shikoni këtë sfidë ne raport me klimën aktuale, edhe çfarë mendoni që mund të bëni ndryshe nga sa ka ndodhur deri me sot me fillimin me ngritjen dhe fillimin e funksionimit të organeve të tjera të sistemit të drejtësisë. Sepse dhe ato ishin parashikuar në Kushtetute dhe ligj por nga momenti deri sa u zgjodhën dhe madje dhe pasi u zgjodhën deri sa filluan funksionimin, me aq sa unë kam dijeni, kanë patur probleme.

Kandidati Eris Hysi merr fjalën dhe duke falënderuar për pyetjet përgjigjet se për të përcaktuar një kohë të saktë se sa do të duhet për të ngutur një institucione është një pyetje që është shumë e vështirë për momentin. Mund të them një muaj mund të them gjashtë muaj por procesi është shumë i ndërlikuar, siç thashë edhe me përpara, me institucionet tjera sic janë KLGJ KLP. Dihet procedura që kandidati interesuar duhet tashme të kishte paraqitur interesin e tij për të bërë ILD . Mendoj që për të mos kaluar në parashikime që janë të pamundura por një periudhë gjashtë mujore mund të jetë e mjaftueshme për të identifikuar nëse ka individë që do jenë edhe të interesuar për të qënë pjesë e ILD . Si mund tejkalohe dhe si mund të përshpejtohet procesi është vetëm duke punuar ngushtë me KLGJ dhe me KLP, nuk mund të shmang dhe daljen në terren për të kërkuar inspektore që do jenë pjesë e zyrës së ILD-së, dalja në terren nënkuptoj puna me gjykata, puna me zyrat e prokurorisë për të identifikuar kandidatë të mundshëm për këtë pozicion . Por pikë se pari duhet koordinuar me KLGJ dhe KLP se çfarë mund të më ofrojnë këto dy institucione në lidhje me këtë çështje.

Margarita Buhali merr fjalën dhe duke i uruar suksese në kandidim shprehet se ju keni një eksperience të gjatë në fushën e avokatisë. Je në kontakt të drejtpërdrejtëpërgjithësisht me

gjykatat me punën tuaj të përditshme, duke qenë se një çështje përgjithësisht ju mund të keni edhe pretendime për shkaqe procedurale dhe mund të keni bërë edhe ankime dhe rekurse. Doja të dija në sa raste keni bërë ankese vetë ju personalisht ose zyra juaj ndaj gjyqtareve, po flas për procedim disiplinorë dhe jo ankimet që është e drejta juaj ne aspektin procedural. Dhe tjetra duke qenë se janë të lidhura, duke qenë se keni një eksperience të gjatë në fushën e avokatisë dhe për më tepër jeni edhe avokate në një zyre avokatie, si mendoni të shmangeni në rast se jeni në kushtet e konfliktit dhe papajtueshmërisë për çështje konkrete që kanë lidhje me ndjekjen nga zyra juaj. Si do ta zgjidhni ju?

Kandidati Eris Hysi merr fjalën dhe duke falënderuar për pyetjet përgjigjet se për sa i përket pyetjes se pare unë personalisht dhe si zyrë ne nuk kemi paraqitur ankime ndaj gjyqtareve në proceset gjyqësore dhe kjo për shkak se nëse ka patur ndonjë problematike në shkallë të parë dihet që ka shkallë të tjera gjykimi të cilat në një mënyrë apo tjetër do ti japin drejtësi procesit. Vështirësi ka patur në ushtrimin profesionit madje e shoh që dhe pozicioni i inspektorit duke u parë nga këndvështrimi i avokatisë është akoma dhe më mirë pasi sjell përballjen me të dyja anët e medaljes dhe me gjyqësorin apo prokurorinë kur ka pasur të tilla, por nga ana tjetër dhe duke përfaqësuar qytetarin në përballjen e tyre me gjykatën, kjo për sa i përket pyetjes së parë. Përsa i përket pyetjes së dytë kam të drejtën e ushtrimit të profesionit të avokatit. Në momentin që do më jepet mundësia dhe nderi të jem në pozicionin e ILD do jap dorëheqjen nga ushtrimi i profesionit, kjo dhe në bazë të ligjit, nëse do të ketë çështje që përbejnë një konflikt interesi, për ato çështje në të cilat zyra apo unë kam qenë palë, padyshim që nuk do trajtohen nga individë që kanë konflikt interesi. Inspektori i Lartë i Drejtësisë drejtpërdrejt nuk shqyrton çështje, janë inspektorët ato të cilët do ti shqyrtojnë rast pas rasti dhe do të japin vlerësimin e tyre. Nëse unë apo ndonjë nga personat e tjerë do jenë në kushtet e konfliktit të interesit ose prej meje do jepet dorëheqja dhe ka ndonjë zv/ inspektor apo inspektorë të tjerë që do të trajtojnë çështjen, ose inspektorit që punon apo është në kushtet e konfliktit të interesit do ti kërkohet të japë dorëheqjen që të shmanget çfarëdo lloj problematike në zgjidhjen e rastit konkret që mund të jetë.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shtron pyetjen se nga CV-ja juaj dhe pak a shumë nga eksperiencia e gjatë që keni, doja të dija cila është eksperiencia juaj në fushën penale? Sidomos në aspektin procedural penal, përderisa ju e dini shumë mirë që inspektori, për herë të parë ka kontrollin me pjesën e prokurorisë, gjë e cila qe ska qënë më përpara .

Kandidati Eris Hysi merr fjalën dhe përgjigjet se në baze të CV që kam paraqitur, e kam shprehur, le të themi fusha penale është një ndër fushat më të kufizuara me te cilën unë nuk jam marrë drejtpërdrejt. Raste që kam asistuar kanë qenë raste kryesisht të arbitrazheve që kane

kërkuar një mbështetje dhe në aspektin e procedurës penale, por kam përshtypjen që kjo ane mund të superohet në raste se inspektorët që do vijnë nga prokuroria do jenë bashkëpunues .

Margarita Buhali merr fjalën dhe shtron pyetjen se dmth ju mendoni se mund ta zgjidhni me pjesën e stafit që do të përzgjidhni, pjesën që flas për eksperiencën?

Kandidati Eris Hysi merr fjalën dhe përgjigjet se pa dyshim që është i rëndësishëm për ILD për sa i përket përfaqësimit, përcaktimit të disa rregullave të funksionimit të institucionit. Ato që realisht do të kryejnë punën janë inspektorët dhe prandaj dhe theksin në platformën dhe vizionin tim, por edhe në sfidën time, është pikërisht përzgjedhja e kandidatëve me të përshtatshme me integritet moral që të kryerjen detyrat në mënyrën më të mirë të mundshme. Aspektin penal padysim që do e mbulojnë inspektorët që do vijnë nga prokuroria.

Eriol Roshi merr fjalën dhe shtron pyetjen se pyetjen për konfliktin interesit e ngriti kolegja më parë. Duke iu uruar suksese kandidatës, doja të pyesja për çështjen që për të qenë dhe të drejtë me kandidatët. Çështja që ngrita dhe pyetjen që i bëra kandidatit më parë. A mendoni krijon mbivendosje mes ILD dhe veprimtarisë së KPK në të ardhmen sepse ju informoj se siç mund dini, nëse do filloni këtë detyrë, do të gjeni shumë ankesa që paralelisht trajtohen dhe nga KPK dhe nga KPA që janë në inspektorat, ka mbivendosje mes këtyre dy institucioneve dhe si do ta shmangnit këtë që çdo institucion të zbatojë kompetencat e tij?

Kandidati Eris Hysi merr fjalën dhe duke falënderuar për pyetjen përgjigjet se në çdo rast të ankimeve që do vijnë për gjyqtarë apo prokurorë të ndryshëm duhet parë dhe në aspektin kohor dhe më pas dhe në aspektin procedural nëse ka ankesa që tashmë ndodhe në KPK dhe janë gjyqtarë të cilët i janë nënshtruar vlerësimit apo janë në proces vlerësimi unë mendoj që është konflikt interesi që të ndërhyjë dhe ILD. Për ata magistratë të cilët presin por nuk janë në procedurë verifikimi Inspektori mund të ushtrojë kompetencat në bazë të ligjit dhe vetëm për atë fokus dhe atë kompetencë që i jep ligji. Është e vërtetë që ka mbivendosje kompetencash në momentin që mund të ngrihet ILD por kam përshtypjen që ekzistojnë dhe mënyra për ta shmangur atë. Njëra është ajo që sapo unë e thashë dhe tjetra do jetë dhe duke komunikuar me institucionin përkatës duke parë dhe ecurinë e një procedimi përkatës ndaj një magistrati.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se po e bëj dhe unë pyetjen tjetër. Në fakt nuk e di a e keni dëgjuar, ka një nismë ligjvënëse nga Kuvendi që për një periudhë kalimtare, nëse nuk gaboj afërsisht 6 muaj, kompetencat e ILD i ngarkohen ti ushtrojë përkohësisht KLGJ, KLP. Tani vendoseni veten në pozicionin e ILD dhe ju kërkohet tani, në këtë moment, një mendim, çfarë mendoni për këtë nismë, a i sjell ndonjë vlerë procesit të ndërtimit dhe startimit të këtij institucioni, a mendoni se do ju cenonte juve kompetencat që ju ngarkon Kushtetuta e kështu më radhë?

Kandidati Eris Hysi merr fjalën dhe përgjigjet se për mendimin tim, është një nismë e nxituar kjo ne momentin qe po jepet një zgjidhje përfundimtare edhe emërimit te ILD. Tashme publikimi i kompetencave ne KPK eshte nje problem me vete. Nëse do të ndërhyhej edhe me KLGj dhe KLP, për më tepër te dyja institucionet, do të dilnin jashtë fushës së kompetencës se tyre të përcaktuar ne Kushtetutë., Mendoj se është një nisme e nxituar ndoshta ka qenë e duhur ne një moment të mëpërparshëm sepse ka qenë periudhe shumë e gjatë nga momenti i daljes se ligjit deri me sot për te ngritur nje institucion por tani që përzgjedhjes,pra procesit, po i vjen fundi, mendoj se nuk është me vendi për një nismë të tillë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani pasi vëren se nuk ka pyetje te tjera, orienton vijimin e intervistës, në pjesën e dytë të saj, lidhur me vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhës angleze, me ekspertin që është e pranishme dhe do të jetë ajo që do të zhvillojë bisedën për aq sa e vlerëson të arsyeshme.

Ekspertja Dr.Ogerta Stroka Koruti zhvillon bisedën e lirë dhe me pyetje përgjigje me kandidaten Eris Hysi në gjuhën angleze (kohazgjatja e kësaj pjese të intervistës rreth 6 minuta)

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani pasi përfundimit të bisedës në gjuhën angleze shprehet se kjo është pjesa e fundit e intervistës me kandidatin Eris Hysi. Duke ju falënderuar për seriozitetin ne prezantim dhe për tju përgjigjur pyetjeve dhe duke iu uruar suksese dhe mbarësi, mund të largoheni. Mund të njoftohet kandidati tjetër.

Meqenëse nuk ka kandidatë të tjerë për bisedim në gjuhën e huaj, largohet nga mbledhja eksperta Dr. Orgerta Stroka Koruti.

Ndërpriten intervistat për një pushim të shkurtër 5 minutësh.

Pas pushimit të shkurtër thirret dhe paraqitet kandidatja per Inspektor i Lartë i Drejtësisë Joana Asimi Sorraj.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën shprehet se rifillojmë mbledhjen pas një pushimi të shkurtër. Fleminderit Znj. Joana për durimin ne fakt sepse sipas programimit paraprak duhet të ishit më përpara me intervistën por na ka marrë më shumë kohë ky proces. Sikurse jeni njohur nëpërmjet ligjit dhe e akteve tona nënligjore, pjese e veprimeve te cilat zhvillohen ne kuadër të vlerësimit dhe të renditjes se kandidaturës, është dhe intervista me kandidatin e cila është e ndarë në tre pjesë, ose në dy pjesë. Pjesa e pare është një prezantim i juaj i përmbledhur , ju motivimin e keni me shkrim besoj edhe te depozituar. Pjesa e dytë është përgjigje e pyetjeve, nëse e vlerësoni përgjigjeni, që mund tu drejtojhen eventualisht dhe pjesa e tretë do të ishte intervista bashkëbisedimi juaj me një ekspert, por që në rastin tuaj KED vlerësoi që, meqenëse ju keni studiuar dhe jeni arsimuar ne Itali dhe zgjedhja juaj ishte për tu testuar ne gjuhën italiane, vlerësuam qe të mos ta bëjmë këtë pjesë interviste. Kështu qe pjesën e tretë nuk e keni. Përpara se

te fillojmë ju i njihni sepse jemi kolegë, pra ju e njihni përbërjen e Këshillit, besoj edhe znj Erinda e njihni. Do tju kërkoja që të shpreheshit nëse e vëreni papajtueshmi apo konflikt interesi me pjesëmarrësit në mbledhje.

Kandidatja Joanan Asimi Sorraj, merr fjalën dhe shprehet: Përshëndetje të nderuar. Si fillim dua të falënderoj për vlerësimin që i keni bere kandidaturës sime, për faktin që jam këtu për të bërë intervistën dhe që ju më vlerësuat për të arritur në këtë fazë. Jam shume e emocionuar dhe me falni per intonacionin e zërit. Është një solemnitet dhe emocion shumë i madh të jem para jush. Nuk kam asnjë konflikt interesi me askënd prej anëtareve.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën shprehet se tani mund të filloni. Mbani parasysh që meqenëse e keni me shkrim dhe ne kemi pasur, keni sjellë dhe kopje të tjera, nuk është e nevojshme të lexohen tërësisht nga ju, por merrni atë kohë të nevojshme për të evidentuar ato gjëra që ju mendoni se janë më të rëndësishme.

Kandidatja Joana Asimi Sorraj merr fjalën dhe parashtrohet për mbledhjen e platformës së paraqitur me shkrim, e cila bëhet pjese e dosjes se kandidatit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon kandidaten nëse ka ndonjë moment tjetër të rëndësishëm për të evidentuar dhe nese jo, pastaj ne vazhdojme me pyetjet.

Kandidatja Joana Asimi Sorraj merr fjalën dhe shprhet se kam edhe diçka tjetër që ndoshta kanë ngelur pa shpjeguar mbi kuadrin e bashkëpunimit ndërinstytucional.

Kandidatja Joana Asimi Sorraj merr fjalën dhe vijon me parashtimin e përmbledhjes së platformës se saj.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe informon se do të kalojmë në momentin e dyte që janë pyetjet e anëtarëve dhe siç bëme me kandidatet tjerë po filloj unë i pari. Kam pak a shumë të njëjtën pyetje. Është një institucion i ri kushtetues. Nuk është problemi se do zgjidhet vetëm Inspektori por do te krijohet edhe institucioni i ILD. Si e mendoni duke pare edhe kohën që ka marrë edhe institucioni ku ju punoni aktualisht, por edhe institucionet e tjera të miratuar pas reformës në drejtësi, sa kohë mendoni se do tu marri? Kush janë problemet që lidhen me këtë kohëzgjatje dhe ku do mbështeteni për të mundësuar, nëse ju do ishit e zgjedhur Inspektor, për bërjen funksionale të këtij institucioni të ri në formën me të mirë të mundshme? Duke pasur parasysh edhe pak klimën dhe vështirësinë për të gjetur njerëz.

Kandidatja Joana Asimi Sorraj merr fjalën dhe përgjigjet se ndoshta për hir të punës që unë kryej prej dy vjetësh si këshilltare pranë KKP dhe investimi që kam bërë në kohen dhe energjinë e ne gjithçka, unë besoj tek kjo reformë dhe atë vendosmeri qe ma karakterizon dhe nga besimi i madh në këtë reforme, puna do jetë në shumë drejtime se në të njëjtën kohë është buxheti, struktura dhe infrastruktura dhe në të njëjtën kohe është stafi. Sepsestafi duhet të veproje

në emër të Inspektorit, pra është edhe figura e Inspektoratit. Ka nevojë aktualisht ky vend, kemi nevojë të gjithë për krijimin e një figure. Ok mbaroi vetingu, por kur të përfundoje vetingu u bënë 5 vjet, u bë edhe kontrolli dhe pastaj mund të gjendemi përsëri me persona që abuzojnë me ligjin. Ka shumë rëndësi për mua përzgjedhja e stafit, rekrutimi i inspektoreve të cilët duhet të jenë figura me integritet shumë të lartë. Edhe në bazë të VKM që doli, akti nënligjor që doli në korrik, janë të parashikuara të gjitha kriteret që duhen ndjekur për të përzgjedhur inspektorët që pak a shumë janë të njëjta e që duhet të ndiqen gjatë procesit të vlerësimit. Një drejtim tjetër duhet të jetë buxheti dhe infrastruktura. Drejtim tjetër që është shumë i rëndësishëm është hartimi e akteve. Kemi një ligj, por si do të funksionojë? Ndaj duhen rregulloret, manualët. Çdo gjë duhet të jetë e përcaktuar e qartë në çdo detaj. Nuk duhet ti lihet asgjë rastit sepse inspektimet duhet të kenë tematika të caktuara, duhen të jenë të programuara. Hetimet kanë etapa. Verifikimi i ankesave ka etapa që janë të parashikuara ligjërisht dhe nuk jemi tek ato zvarritjet e pafundme të ankesave. Dhe të gjitha këto, përveç se duhet të bëhen, duhet punuar për to në të njëjtën kohë sepse populli duhet të fillojë të shikojë rezultatet e para, të informohet dhe jo të jetë i mbyllur, të jetë i pa aksesueshëm. Pra për pyetjen që më bëni mendoj se duhet punuar në të njëjtën kohë në shumë drejtime. Besoj se ka shumë dëshirë, vullnet dhe ka shumë profesioniste që mund të kontribuojnë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se kam edhe një pyetje. Juve punoni pranë KPK. Mund të mos i përgjigjeni kësaj pyetje se ka tjetër natyrë. Me aq sa e njoh modestisht dhe me sa e kuptoj, qëllimi natyral dhe funksioni i organeve të rivlerësimit kalimtar me të ILD nuk janë të njëjta, por në fund, një gjë të përbashkët e kanë, kontrollin, hetimin dhe nxjerrin rezultatet. Nëse ju do zgjidheshit ILD çfarë nuk do të bënit nga ajo që bën aktualisht KPK? Mund edhe të mos përgjigjeni.

Kandidatja Joana Asimi Sorraj merr fjalën dhe përgjigjet se jo për tju kthyer një përgjigje thjesht duke bërë një krahasim të legjislacionit, shoh që ILD ka shumë hapësirë ligjore për të vepruar, duke parashikuar edhe masa të ndryshme, për shkelje të ndryshme disiplinore, të cilat KPK dhe organet e procesit të rivlerësimit nuk i kanë. Shumë raste kur ka vend për masa disiplinore i dërgohen organeve kompetente për hetime të mëtejshme. Ndërkohë ILD i ka këto kompetenca të parashikuara dhe shpesh me ndryshime ligjore, ligji nr.49/2019, në mos gaboj, këto ndryshime të fundit ligjore kanë parashikuar edhe të gjitha masat dhe shkeljet disiplinore dhe ka më shumë hapësirë dhe e shikoj si mundësi për më shumë efektivitet, veprim dhe shume efikas për veprimtarinë e ILD.

Margarita Buhali merr fjalën dhe duke i uruar suksese për kandidimin tuaj shprehet se në fakt, duke parë CV –në tuaj, konstatoj që keni një eksperiencë të gjatë në fushën e mësimdhënies, kurse për sa i përket pjesës së eksperiencës suaj menaxheriale është më e pakët sepse

përgjithësisht keni mbajtur detyrat e specialisteve, këshilltareve ligjore. Në këto pozicione pune që ju keni mbajtur aq sa mundieshit, keni dhënë ndonjëherë këshillime ose asistime persa i përket menaxhimit të institucionit?

Kandidatja Joana Asimi Sorraj merr fjalën dhe përgjigjet se dua të theksoj që unë e kam filluar karrierën time duke qene pedagoge dhe më pas shefe departamenti ne Universitetin e Vlorës, në Fakultetin Juridik. Në kohën kur kam qene shefe e departamentit, kam qene edhe shefja e parë e departamentit që funksiononte me dy pedagoge të brendshëm dhe me një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh dhe prokurores. Është e vërtetë që aty një pjesë të madhe të punës e kam bërë vetë se kemi qene një staf i vogël dhe ka qene një numër i madh gjyqtarësh e prokuroresh të cilët ishin të angazhuar me mësimdhënie dhe aty me të vërtetë ndoshta kam bërë një punë shumë të madhe vetë. Por kam arritur të menaxhoj dhe të me falni për mungesën e modestisë, që një universitet të eci para. Pra kane qene një vit e gjysme, dy vjet që e kam pasur këtë eksperience në nivelin menaxhial nëse mund të jetë ezauruese për pyetjen tuaj.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se duke parë pozicionin që ju keni aktualisht si këshilltare ligjore, unë jua kam bërë më shumë këshilltareve ligjore përgjithësisht këtë pyetje, është në vlerësimin tuaj tju përgjigjeni apo jo ashtu siç tha kryetari sepse është pak delikate, nuk e di sa e pavarur keni qene ju për të dhënë këshillime pranë një komisioni aq të rëndësishëm si KPK dhe sa herë e keni shfaqur atë pavarësisht vendimmarrjes që ka pasur komisioni? Sepse është një fakt i njohur që ka pasur shumë raste kur komisioni, qoftë për prokuroret, qoftë për gjyqtarët ka vendosur që të dërgojë procedime përkatëse për efekt të procedimit disiplinor pranë institucioneve përkatëse. Doja të dija në aspektin procedural mbi guximi juaj për të pasur një mendim ndryshe nga komisioni. Është një pyetje që unë ua kam bërë edhe këshilltarëve aktualisht që janë dhe gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Kandidatja Joana Asimi Sorraj merr fjalën dhe duke e falënderuar për pyetjen, përgjigjet se e vlerësoj shumë këtë pyetje. Dy fjale për sa i përket punës së këshilltarit ligjor në KPK. Detyra jone parësore është hartimi i relacioneve. Hartimi i relacioneve bëhet duke patur parasysh vetëm dokumentet dhe fakte. Më pas procedura ecën në hartimin e rezultateve të hetimit por ju garantoj dhe nisur nga fakti që i vetmi gjyqtarë që kam për veten time është ndërgjegjja ime, ua them me ndërgjegjen maksimale se deri me sot nuk më ka ndodhur asnjëherë që të më thuhet mua për ta ndryshuar në ndonjë fakt. Unë dorëzoj relacionin ashtu siç e kam detyrimin ligjor. Personat e tjerë vazhdojnë procedurat sipas detyrimeve ligjore. Jua garantoj, i kam vendosur faktet sepse nuk kam fuqi vendimmarrje dhe jam thjesht në aspektin e këshillueses. I kam qëndruar besnik ndërgjegjes sime në radhë të parë sepse është ajo që nuk më lë të flejë gjumë natën, është gjyqtari më i fortë i vetes sime dhe kam qëndruar besnik ndërgjegjes sime, i kam shprehur gjerat siç i kam

parë me vërtetësi faktet dhe dokumentet. Nuk më është kërkuar kurrë të bëj ndryshime në relacionet e mia. Procedura pastaj ka vazhduar sipas ligjit nga organet e tjera, por relacionet detyra ime ligjore është bërë në përputhje me ligjin dhe me ndërgjegjen.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shtron pyetjen se si do ta shmangni, në rast se do tju vije një rast të konfliktit të interesit për një procedim disiplinore ndaj një gjyqtare, për aq sa ju keni punuar në këtë institucion (KPK), si do ta zgjidhni? Kur ju keni qene këshilltare ligjore në verifikimin e gjyqtarit.

Kandidatja Joana Asimi Sorraj merr fjalën dhe përgjigjet se unë nuk kam konflikt interesi sepse nuk jam organ vendimmarrjes për tju shpjeguar që detyra ime si këshilltare ligjore është thjesht këshillimi përgatitja e relacionit sipas fakteve. Unë nuk jam organ vendimmarrjes, janë komisionerët që marrin vendimin, nuk quaj veten që jam në konflikt interesi me të gjithë ato subjekte të rivlerësimit gjyqtare apo prokurore të cilëve u kam bërë relacionet përkatëse.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se, ndoshta për të qenë më e qartë. Mund të ketë pasur në ndonjë vendimmarrje që ju keni bërë këshillime që duhet, pa i paragjykuar se ai është pozicioni juaj dhe ju e dini shumë mirë. Ne po flasim për një aludim nuk dimë konkretisht qëndrimet që ju keni pasur, mund të keni pasur që në aspektin profesional kjo lloj procedure që ka ndjekur gjyqtari sepse pjesë e KPK është dhe vlerësimi profesional ka raste që është dërguar për procedim ka raste që duke është dërguar, ju keni mbajtur mendim që këtu gjyqtari në aspektin procedural duhet të dërgohet për procedim brenda relacionit tuaj kjo është pjesa e relacionit, ndërsa rasti kur gjyqtari vjen përpara jush ose një çështje tjetër ju mendoni se mund të jeni shkak për konflikt interesi, për këtë e kisha se ndoshta nuk isha unë qarte, jo për çdo çështje që është pjesa juaj e zakonshme por atje ku keni pasur një mendim ndryshe, nëse ka qenë në rast se skeni pasur skeni pasur, pa problem.

Kandidatja Joana Asimi Sorraj merr fjalën dhe përgjigjet se deri tani nuk më kanë ndodhur raste të tilla.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se nuk do mërzhiteni se jam në cilësinë e relatores dhe jo të inspektorit, me duket se më shumë po mërzhitën koleget. Konstatoj që një pjesë të periudhës ju keni qenë në Presidencë dhe konstatoj që edhe një kandidat tjetër ka qene në Presidencë, më saktë i nderuari edhe z. Metani. Ka pasur ndonjë marrëdhënie në kuptimin vartës ose kolegë midis jush ?

Kandidatja Joana Asimi Sorraj merr fjalën dhe përgjigjet se është vërtetë që z. Artur Metani ka qenë me detyre këshilltare i Presidentit të Republikës. Unë kam punuar për 8 vite në Presidencë. Ka qenë një periudhe kohore që unë kam qenë ashtu siç e keni të shkruar dhe në CV

dhe në librezën time të punës kam qenë specialiste ligjore pranë këshilltarit ligjor dhe kam punuar me z Metani për një vit.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se thjesht duke qene se në një fare mënyre keni qenë në varësinë e z Metani apo e kuptova une kam gabim?

Kandidatja Joana Asimi Sorraj merr fjalën dhe përgjigjet se kam qenë specialiste pranë këshilltarit ligjor.

Fatjona Memçaj ndërhyt dhe pyet së pari a keni qenë dhe në varësi të kujt keni qenë si specialiste?

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se të lutem ma sqaro, sepse kolegja ka punuar vetë atje, cili ishte raporti juaj i punës? Dua ta kem të qartë.

Kandidatja Joana Asimi Sorraj merr fjalën dhe përgjigjet se detyra ime pranë Institucionit të Presidentit të Republikës ka qene hartimi i dekreteve të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Si specialiste pastaj, kam qenë specialiste pranë Drejtorisë Juridike, kam përfaqësuar i Institucionin e Presidentit të Republikës pranë organeve gjyqësore për mbrojtjen e dekreteve të tij.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se meqenëse paskeni pasur dhe eksperience me këtë kandidat është e vështirë të konkurrosh me njeriun që e njeh? Si e vlerësoni ju?

Kandidatja Joana Asimi Sorraj merr fjalën dhe përgjigjet se unë nuk konkurroj me askënd, unë konkurroj me veten. Unë kam vetëm një sfidë dhe me të vërtetë ka qenë shumë vështirë, sepse siç e patë nga CV ime, unë jam një person që kam punuar specialiste në pjesën më të madhe dhe si mësimdhënëse që është pasioni im. Por jam specialiste, më falni për modestinë se është here e pare që gjendem për të folur me unë unë, por më falni jam e detyruar ...

Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se këti për veten duhet të flisni, ndaj nuk ka asnjë problem se duhet të flisni për veten. Ne ju thirrëm në pyetje.

Kandidatja Joana Asimi Sorraj merr fjalën dhe përgjigjet se më falni për mungesë modestie, por është e vërtetë që kam qenë në pozicionin e specialistit. Jam një person dhe nga hetimi duhet të këtë dalë që skam qenë asnjëherë politikisht e përzgjedhur. Kam qenë specialiste, kam mësimdhënësi dhe që e kam bërë doktoraturën kur kam qenë specialiste. Por jam person që kërkoj shumë nga vetja. Kam qenë shume në dilemë të bëj aplikim apo jo. Kur kam hyrë në konkurrim kam hyrë në konkurrim me veten për të treguar vetes unë për veten time me gjithë respektin që mund të kem për katër konkurrentet e tjerë. Sfidat janë personale për të treguar që unë mendoj se gjerat ndryshojnë apo ndryshojnë në këtë nivel që një person që nuk ka mbështetje politike, një person që nuk ka mbështetje partiake e që nuk ka pasur kurrë teser partie apo një person që nuk ka trokitur dyerve për të kërkuar punë, por e kam paraqitur një CV, që më falni kjo

është mungesë modestie totale por është CV që mund të jetë më mirë se ajo e personave drejtues që mund të kenë mbështetje. Prandaj mendova pse të mos e provoj. Vizionin e kam, shyqyr atë gjykatësin, ndërgjegjen që të bëj gjumin rehat natën, e kam. Besoj në këtë që po bëj. Punoj 11 orë aktualisht në pozicionin e punës që jam, perse te mos e provoj. Kështu që kam respekt për të gjithë personat e tjerë. Por unë kam hyrë në këtë sfidë për të konkurruar Joanën, për të parë veten time, për të treguar se nuk është se kam nevojë për miratimin e dikujt tjetër për të ditur sa vlej unë sepse ju thashë jam person që kërkoj edhe në pozicionin e specialistes të gjendem komod, duke kërkuar te perfeksionoj veten por perse jo është një mundësi.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet: patjetër Joana. Nuk e vë në dyshim, por kjo ishte më shumë tek motivimi, tek ajo që ju shtyu dhe përgjithësisht për të qenë dhe tek pjesa e kandidateve të Gjykatës Kushtetuese, ato e kishin pjesë të tyre letër-motivimin. Inspektori është një natyrë tjetër. Por që edhe kjo na shërbeu të kuptonim më mirë atë që ju shtyn të merrni një hap kaq të rëndësishëm për atë pozicion që më shumë se një karrierë, për mua është një përgjegjësi e madhe. Kështu që ju uroj suksese.

Fatjona Memçaj merr fjalën dhe shprehet se znj. Joana gjithmonë jemi skeptik si Këshill, pasi edhe nëse i referohemi metodologjisë së pikëzimit të kandidateve ku një pjesë të veçante zë aspekti i vendimmarrës si kandidat, pra sa aftësi vendimmarrëse ka dhe sa është sprovuar në vendimmarrje. Si e vlerësoni, dmth. në pozicionet e pedagogut dhe specialistes kjo aftësi nuk është shume e spikatur. Dihet se çfarë funksionesh ka specialisti, ne aspektin pedagogut deri diku është e ezauruar. Si do të bindni Këshillin që do të jeni përshtatshme për vendimmarrje të rëndësishme siç ka Inspektori ? Sepse nuk është e vogël pesha që ai ka në sistem. Është personi me i rëndësishëm në sistem. Kemi të bëjmë me gjyqtare dhe prokurore. Pavarësisht se po vetoheми, do procedohemi, por jemi profesioniste, jemi njerëz dhe çdo lloj vendimmarrje e inspektorit influencon tek individi gjyqtarë dhe prokurorë, influencon tek karriera e secilit prej nesh kështu që me çfarë do na bindni ne që vendimmarrja jote do jete vendimmarrja e duhur dhe do kesh aftësitë dhe cilësitë për një vendimmarrje të duhur besoj jam e qartë?

Kandidatja Joana Asimi Sorraj merr fjalën dhe duke e falënderuar për pyetjen përgjigjet se është e vërtete që ky komision i nderuar, ky Këshill konstatoi që unë nuk kam pasur pozicione drejtuese që të mund te bindet te tregoj për vendimmarrjen që jam në gjendje apo jo për të kryer. Kam qenë për një periudhe kohore edhe specialiste pranë Drejtorisë Juridike në Bashkinë e Tiranës. Ka qenë një periudhë, një detyrë shumë e vështirë sepse hartoheshin projekt-vendime për Këshillin Bashkiak. Kam ditur të them jo. Unë di të them jo. Di ti them jo një eprori. Kaq mund tju them j dhe u duhet ti besoni fjalës sime sepse unë nuk e kam një detyrë të tille kjo shihet, por jam në gjendje ti them një jo. Unë jam në gjendje ti them eprorit që ligjërisht kjo gjë nuk

bëhet, ligjërisht mund të bëjmë këtë gjënë tjetër. Jam në gjendje të gjej rrugën dhe shtegun ligjor por gjithmonë shtegun ligjor dhe asnjëherë nuk e kam bërë deri me sot në detyrën time të specialistit sepse aty e kam ndërë peshën e te thënit jo në projekt-vendimet për Këshillin Bashkiak. Këtë gjë nuk mund ta bëj, por jam juriste e shoh ligjin, është e shkruar e zezë në të bardhë dhe interpretimit të bërë duke iu referuar vendime të Gjykatës Kushtetuese dhe të vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe e bëje në këtë rrugën tjetër por nuk bëj diçka me detyrim. Jam në gjendje të dorëzoj çelësat në fund të fundit në atë vend pune, por që të bëj diçka që nuk është ligjor, jo. Vetëm ligjin kam guiden time, biblën time.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet doja të thoshja, thjesht për ta qetësuar kandidaten, thjesht besoj që edhe kolegja ime kemi qenë në të njëjtën sens, për të kuptuar pavarësinë dhe vendosmërinë tuaj e që ju e treguat sejeni nga Vlora dhe nga ana e mirë, kështu që unë ju uroj suksese. Kjo ishte dhe për të hequr pak si të thuash emocionet.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe falënderon kandidaten. Intervista me ju e mbyllur dhe mund të largoheni.

Thirret dhe paraqitet kandidatja per Inspektor i Lartë i Drejtësisë Lindita Troja.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën shprehet se faleminderit që duruat pak, sepse koha ka kaluar dhe është në fakt jashtë parashikimit të përafërt, por besoj se na mirëkuptoni, nuk kemi ndenjur kot. Siç e njihni dhe vetë ligjin edhe procedurat intervista është pjesë e fazës së vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit për efekt të renditjes së tij në kandidim, që vjen mbas fazës së verifikimit. Dhe në pjesën e intervistës janë 2 elementë, në rastin tuaj. Në njërin që ju mund të parashtroni në mënyrë të përmbledhur, ashtu si juve e vlerësoni, kush janë arsyet e motivimit për të kandiduar? Kush mund të ishte vizioni, platforma, apo elementet kryesor të platformës dhe të vizionit, sesi ky institucion i ri kushtetues do të ngrihet pra, do të bëhet funksional dhe do të ushtrojë detyrat ashtu siç e parashikon ligji. Pas parashtrimit tuaj të lirë, ku sigurisht do ta vlerësoni vetë se kush janë elementët e rëndësishëm, do të ketë besoj pyetje që ju drejtohen nga anëtarët e Këshillit dhe ju mund ta vlerësoni për të dhënë përgjigje apo jo. Kështu që mund të filloni.

Kandidatja Lindita Troja merr fjalën dhe duke falënderuar Këshillit shprehet se së pari, ju them se ndihem e nderuar që jam këtu përpara jush, domethënë si qytetare dhe si juriste që kam një eksperiencë punë prej 22 vitesh e që punoj pranë Institucionit të Bashkisë së Tiranës. Referuar nenit 147 pika “d” e Kushtetutës si dhe të ligjit nr. 115/ 2016 “ Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë”, unë do të shpreh çfarë mendoj mbi funksionimin e këtij institucioni dhe duke parë, duke u nisur nga objektivi i këtij institucioni të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, çfarë ka të shprehur në ligj, në objektivin e punës së tij, them që kam bindje e që besoj edhe në punën

time disa vjeçare gati 22 vjeçare pranë Institucionit Bashkia Tiranë, e në përvojën time që kam në ndjekjen e dhjetra, qindra proceseve gjyqësore gjatë gjithë këtyre 22 viteve punë. Duke ndjekur gjithë këto procese gjyqësore them që kam qenë më afër sistemit të Drejtësisë, sepse mund të ketë pasur raste që mund të kemi pasur dhe 4 procese gjyqësore në ditë. Është edhe shtimi i gamës së tyre nga ana e Gjykatës Administrative në vitin 2013 eqë na është shtuar akoma edhe më shumë puna ne si institucion sepse Bashkia e Tiranës është shumë shpesh në pozicionin e palës së paditur në këto procese. Përveç Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, mund të them që kam marrë pjesë më shpesh edhe në Gjykatën e Apelit Administrativ , e cila ka ndryshuar tani procedurat dhe po i bën çështjet jo më në dhoma këshillimi por më shumë në seanca gjyqësore. Ndaj më nxit ajo dëshira edhe pasioni që kam për punët që edhe në Gjykatën e Apelit të shkoj e të paraqitem po aq denjësisht sa në Gjykatën e Shkallës së Parë. Kjo është edhe diçka që si mund ta themi pjesë e ndërjegjes në punën time. Kam bërë dhe çështje pranë Gjykatës së Lartë, megjithëse në Gjykatën e Lartë është shpesh edhe Avokati i Shtetit. Por ne si institucion dhe unë si juriste e Bashkisë së Tiranës nuk e kemi lënë kurrë që çështjet t'na i mbroj vetëm avokati i shtetit, kemi ardhur vetë, edhe me atë besimin në veten tonë.

Tani përveç pjesëmarrjes në procese të ndryshme gjyqësore që objekti i gjyqeve ka qenë nga më të ndryshmet, mund të themi për shpërblim dëmi, shfuqizim akti administrative, ndryshimet e vendimeve të qeverisë janë objekte: ose pavërtetësi e këtyrë akteve të gjëndjes civile. Them që unë kam një eksperiencë edhe në komunikimin shkresor midis, me institucionet e tjera, për arsye se, sepse pranë Bashkisë Tiranë, institucionit që unë kam 22 vite pune që punoj vijmë ankesa nga qytetarë të ndryshëm për probleme të ndryshme, dhe një nga pikat e Drejtorisë Juridike që unë kam punuar më parë se ne kemi qenë vetëm 5 juriste në Drejtorinë Juridike, përveç proceseve gjyqësore kthenim përgjigje të të gjithë anksave të qytetarve mbi problematika të ndryshme. Dhe kjo ka bërë që nëve të kemi një korrespondencë si institucion me Agjensinë e Trajtimit të Pronës, më Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajthshme që tani është bërë Agjensia e Kadastrës.

Mbi vizioni që kam unë për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, nuk dua që anëtarët të mërzhiten, të dëgjojnë, aq sa unë do ti them me pika shumë shkurt se çfarë kam unë menduar në lidhje me këtë kandidim dhe përse unë kam kandiduar për këtë pozicion. Tani së pari duke i nisur nga objektivi i ligjit, që është i përcaktuar tek ligji 115/2016, tek neni 194 jepen objektivat e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Së pari është verifikimi i nkesave. Ankesat e qytetarëve janë bashkëshoqëruese të të gjithë proceseve gjyqësore, disa kanë të drejtë, disa qëndrojnë, disa nuk qëndrojnë. Kjo është një e drejtë e çdo qytetari që ka të drejtën e tij të ankimit por verifikimi i këtyre ka vlerë për mua sepse dua të bëhet një, të jetë sa më objektiv i paanshëm

dhe i pa domethënë në kthimin e përgjigjeve dua që e para të jetë brënda afateve ligjore sipas kodit të procedurës administrative dhe të jenë në mënyrë objektive të paanshme dhe të pavarur. Gjithashtu mendoj, në rast se unë do ta fitoj këtë pozicion punë dua të bëj një plan masash në lidhje me këto ankesat e patrajuara sepse ka kaluar një kohë e gjatë dhe një pjesë e këtyre mund të kenë mbetur dhe nuk janë trajtuar. Prandaj mendoj të bëj një plan efikas në lidhje me kthimin e përgjigjeve të ankesave të patrajuara. Nga ana tjetër, së dyti, është objektivi i punës së këtij ligji është edhe hetimi disiplinor. Për këtë do nisem gjithmonë nga parimet kryesore që është një proces i rregullt ligjor, e drejta për tu dëgjuar, parimi i barazisë përpara ligjit, parimi i proporcionalitetit etj. Rëndësi ka në këtë rast se, në rast se do fillojmë një hetim, është siç e kemi edhe ne në punë. Kur fillon të merret një masë disiplinore për një nëpunës civil, rëndësi ka shkaku i shkeljes disiplinore mendoj unë. Domethënë meqënëse kam qenë dhe në disa si nëpunës e vjetër, siç e ka dhe ligji për Statusin e Nënpunësit Civil që marr pjesë në këto Komisione, e kryesorja është shkaku i shkeljes disiplinore. Kjo shkelje përbën shkak që ky njeri të filloi procedimi, hetimi disiplinor për këtë person. Pra, prandaj duke u nisur nga këto, nga eksperiencia e punës që kam, mendoj që edhe kjo Zyra e Inspektorëve, rëndësi të madhe ka zyra e inspektorët të ILD, pasi Inspektorët janë ata që të parët që bien në kontakt direkt me ankesat, këta domethënë do fillojnë procedurën dhe Inspektori që është, që firmos raportin përfundimtar vlera e tija është pikërisht te kjo, tek puna, tek kthimi i përgjigjes dhe zbatimi i ligjit nga ana e Inspektorit të zyrës së Inspektorit. Në Korrik të këtij viti, nga çfarë jam njohur nga këto media, Kuvendi i Shqipërisë, ka plotësuar kuadrin ligjor për të gjitha kategoritë e veprimeve dhe mosveprimeve që përbëjnë shkelje disiplinore të magistratëve, pra, në këtë moment që flasim është krijuar dhe kuadri ligjor i plotë për funksionimin e këtij institucioni.

Për sa i përket pjesës menaxheriale. Tani, gjithmonë duke qënë Inspektori i Lartë i Drejtësisë është një person publik i cili ka buxhetin e vetë të pavarur që në vitin 2020 nga ana e buxhetit të shtetit, më ç'kam lexuar është krijuar një buxhet, është për funksionimin e këtij institucioni. Kurse përsa i përket strukturës, ligji e ka të përcaktuar Struktura e Zyrës së ILD-së është, një pjesë janë magistratë dhe pjesa tjetër do të jenë nëpunës që do të nënshtrohen ligjit për statusin e nëpunësit civil. Pak e shumë këto janë vizionet e mia në lidhje me këtë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe duke e falënderuar për parashtrimin shprehet kam një pyetje. Ju thatë ju keni 22 vjet në Bashkinë e Tiranës, përpos çdo gjëje tjetër, është një gjë jo e zakonshme për realitetin Shqiptar, për fat të keq, që ndryshimet politike gjithmonë sjellin ardhje dhe largime të vazhdueshme të nëpunësve. Unë shikoj që ju keni qenë gjithmonë aty dhe në fakt nuk paragjykoj kërkënd, por kjo është një vlerë. Fakti që ju jeni aty gjithmonë, kjo është diçka për tu marrë në konsideratë. Pyetja ime do të ishte kjo, në mënyrë të

përmbledhur. Nuk është çështja vetëm për të zgjedhur Inspektorin e Lartë të Drejtësisë por problemi është të krijohet dhe Inspektorati, pra me gjithë përbërjen e tij. Sipas një gjykimit tuaj paraprak, sa kohë do të merrte kjo dhe ku do të mbështeteshit për të arritur, nëse do të ishit titullarë, që të krijonit strukturat e nevojshme dhe të përzgjidhnit njerëzit e duhur për ta bërë funksional Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë?

Kandidatja Lindita Troja merr fjalën dhe përgjigjet se ligji e ka të përcaktuar. Është një periudhë 6 mujore, ma çkam lexuar unë ligjin për Organet e Qeverisjes të sistemit të drejtësisë, ligjin për statusin e nënpunësit, ligjet për statusin e gjyqtarve edhe të prokurorëve. Tani them që duhet një periudhë kohe 6 mujore për përcaktimin e strukturës të Zyrës së Inspektorit si dhe administratës në ndihmë të këtij institucioni, të burimeve njerëzore, për arsye se këto pozicione janë delikate dhe duhet, siç u bë për mua, një kërkim nga të gjitha institucionet për figurën, morale, profesionale etj. Prandaj them që duhet një periudhë kohe besoj 6 mujore për ngritjen e këtij institucioni.

Margarita Buhali merr fjalën dhe duke i uruar suksese në kandidim shprehet se ku keni një eksperiencë të gjatë në punë, si juriste. Unë doja të pyesja më shumë mbi guximin. Sa here të tjera keni guxuar ju të kandidoni në pozicione drejtuese ose diku tjetër jashtë profilit të juristit të Bashkisë? Sa herë të tjera dhe ku? Është problemi se të guxosh të kandidosh dhe nëse përzgjidhesh nuk ka rëndësi, por thjesht për të krijuar ide mbi iniciativën tuaj.

Kandidatja Lindita Troja merr fjalën dhe përgjigjet se ua them me shumë sinqeritet. Punën që kam pasur në Bashkinë e Tiranës e kam dashuruar. Pse? Më ka pëlqyer gjithmonë lëvizja nga një gjykatë në tjetrën, me çështje dhe probleme kanë qenë nga më të ndryshmet. Të them të drejtën jo se nuk kam pasur mundësi të lëviz. Madje shumë nga gjyqtarët, sidomos nga Gjyqtarët e Shkallës së Parë, duke vajtur çdo ditë, nga 3 – 4 gjyqe në ditë, të thuash kemi krijuar respekt reciprok, për gjyqtarët, për kryetarët e gjykatave. Dëshira vetëm më ka mbajtur në atë punë, pasioni dhe kalueshmëria e mirë me kolegët e zyrës juridike. Siç ju thashë në fillim, ne kemi qenë 5 juriste në Drejtorinë Juridike dhe ishim të lidhur shumë me njëri-tjetrin. Nuk vinim re se çfarë pune bën kjo ose ajo. Bënim një punë të gjithanshme dhe bënim punë në Njësitë Bashkiake, dmth përveç Bashkisë së Tiranës, pra mbulonim edhe njësitë bashkiake për çështjet që i kishim të ndryshme. Unë kam qenë juriste tek Njësia 1, 2, 3, 4, 5, sepse Tirana ka pasur 11 Njësi Bashkiake dhe nuk kishin juristë. Vetëm Drejtoria Juridike e Bashkisë së Tiranës mbulonte punën e të gjithëve. Unë të them që ka qenë një punë kolosale që kemi bërë. Dhe këtë punë e kam pëlqyer, e kam bërë me pasion, me devotshmëri. Kështu që, tani më lindi kjo dëshira për këtu natyrshëm. Thashë përse mos të provoj edhe unë diçka. Ja kjo ishte arsyeja.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se kjo është gjë shumë e mirë. Duke qenë se keni pasur eksperiencë në gjyqësor goxha gjatë dhe ndërkohë që keni një marrëdhënie të konsoliduar edhe me titullarin e institucionit nga i cili ju vareni. Nësa raste ju keni pasur një opinion, ndryshe nga titullari, për ta ankimuar një vendim, si e keni shprehur qëndimin tuaj?

Kandidatja Lindita Troja merr fjalën dhe përgjigjet se kur bëhet një ankim nga ana e një juristi, flas jam në pozicionin e specialistes së juristes. Kur ne paraqesim një ankim ndaj një vendimi të një gjykate, firmosin disa persona. Firmos specialisti, shefi i sektorit, drejtori, kalojnë disa faza. Qëllonte që ne kemi pasur dhe mosmarrëveshje. Nuk është se ka qenë gjithçka e thjeshtë. Por me shefin e sektorit psh janë marrë gjithmonë vesh. Kurse kur ka pasur raste që drejtorika pasur mendim tjetër unë kam ngulur në atë timen, për arsye se unë kam qenë juriste me autorizim nga kryetari i Bashkisë dhe në këtë mënyrë unë kam marrë përsipër edhe përgjegjësinë e çështjes. Nëse Drejtori mua më është shprehur që këtë nuk do ta kalojmë, unë kam këmbëngulur dhe e kam kaluar edhe pa firmën e Drejtorit. Kam vajtur tek administratori dhe ia kam shprehur qëndrimin. Prandaj gjithmonë e kam kaluar këtë duke vajtur tek një instancë më lartë.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shtron edhe një pyetje. Po në fushën penale sidomos në fushën e procedurës penale, keni eksperiencë?

Kandidatja Lindita Troja merr fjalën dhe përgjigjet se jo. Unë jam angazhuar vetëm me çështje civile dhe administrative.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se nuk kam përse të mos them që unë konfirmoj atë që tha znj.Lindita, të paktën për Gjykatën time. Vetëm dua ta pyes, në punën që ka kryer në Bashkinë Tiranë, besoj që e ka të lidhur pozicioni i punës me shumë ankesa ose me qytetarë që kanë probleme të mëdha. Besoj se Bashkia e Tiranës është një nga bashkitë që ka numrin më të madh të qytetarëve. Sa do të jetë në gjendje kandidatja , nëse do të zgjidhet Inspektore e Lartë e Drejtësisë, të ndajë anën njerëzore që tek ankesat është gjithmonë prezente nga ajo që është e vërteta, domethënë thelbi i ankesës?

Kandidatja Lindita Troja merr fjalën dhe përgjigjet unë u shpreha edhe më lart që ankesat kanë qenë gjithmonë bashkëshoqëruese të punës time nëpër gjykata dhe në Bashki për probleme të ndryshme. Gjithmonë duke respektuar ligjin, pa anë emocionale, ne i jemi përgjigjur brenda afatit të Kodit të Procedurës Administrative, ajo është 30 ditor. Kur vjen qytetari pranë Bashkisë, vjen pranë ambienteve të marrëdhënieve me qytetarin, bëhet kërkesa, aplikohet, dhe i jepet një afat, afati 30 ditor. Kjo ankesë i dërgohet secilës drejtori përkatëse që duhet ti përgjigjet për ankesën. Mendoj që përgjigja duhet të jetë sa më e saktë, sa më e drejtë, dhe ligjore. Sepse qytetari mund të kërkojë një gjë që është e pamundur ose jo ligjore dhe nuk do ti themi që ke të drejtë. Gjithmonë kjo ka qenë motoja e përgjigjeve që neve kemi bërë ndaj qytetarve të Tiranës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe meqenëse nuk ka pyetje të tjera e falënderon kandidaten për seriozitetin dhe vëmendjen për ti parashtruar Këshillit mendimet dhe për tu përgjigjur pyetjeve dhe i uron suksese.

Thirret dhe paraqitet kandidati për Inspektor i Lartë i Drejtësisë Sokol Stojani.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se besoj na mirëkuptoni për vonesën. Në fakt ishte programuar paraprakisht në kohë, që të ishte pak më herët por rrjedha e programit sot na mori më shumë kohë nga se e mendonim. Intervista me ju, sikurse ju e njihni ligjin zhvillohet në kuadër të procedurës së vlerësimit dhe të pikëzimit të kandidaturës për efekt të renditjes së 5 kandidatëve për vendet vakante. Një nga elementet që përveç dokumentacionit që ju keni prezantuar, dokumentacionit që ne kemi siguruar është edhe intervista me kandidatin. Pjesa e parë e intervistët do të jetë një parashtrim i përgjithshëm nga ju, prezumoj i përmbledhur sepse të tjerat i kemi me shkrim. Lidhur me vizionin, platformën dhe motivimin tuaj për të kandiduar dhe e pasur më pas, me eventualisht me pyetjet që mund të kenë anëtarët e Këshillit në drejtimin tuaj lidhur me këtë kandidim. Paraprakisht, nëse besoj e njihni përbërjen e Këshillit dhe Avokaten e Popullit, në procedurë parashikohet nëse ju vëreni që jeni në kushtet e papatuejshmërisë dhe konfliktit të interesit me ndonjërin prej nesh.

Kandidati Sokol Stojani deklaron se nuk kam asnjë pretendim lidhur më këtë pikë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani fton kandidatin të fillojë me parashtrimin e përmbledhur të motivimit të kandidimit, të cilin e ka me shkrim.

Kandidati Sokol Stojani merr fjalën dhe shprehet se unë në fakt, duke qenë se nuk kishte një lloj strukture dhe duke menduar që na është lënë ne se si duhet ta prezantohemi më mirë, kam menduar se është më e arsyeshme, më racionale, që para këtij Këshilli të jap atë që mendoj sesi do të konfigurohet, cili do të jetë vizioni apo përparësitë e këtij institucioni të rëndësishëm. Jam munduar ta strukturoj në një analizë të shkruar të situatës që diktoj nevojën e këtij organi pak e shumë për të krijuar një tablo të përgjithshme se si erdhëm deri këtu, ligjet për reformën, gjetjet e ekspertëve, synimet e institucionit dhe duke identifikuar detyrat kryesore, si edhe një përshkrim të objektivave afatshkrutra, afatmesme, afatgjatë. Kështu e kam strukturuar dhe tani po mundohem ti paraqes.

Kandidati Sokol Stojani vijon me leximin e dokumentit mbi platformën e tij, të përgatitur me shkrim për ta paraqitur në këtë intervistë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe duke e falënderuar për prezantimin, shprehet se, një ndjesi e imja që dukeni që jeni nga brenda sistemit, sepse e kuptuam thellësinë me të cilin ju e njihni, se si funksionon sistemi jonë i drejtësisë dhe se kush mund të jenë problemet. Por unë do të doja të bëja një pyetje. Duke qenë se edhe juve e përmendët dhe nga eksperiencat

tuaja, në administrimin e punëve përveçse në hetimin etj. Si e mendoni, sa mund të zgjasë dhe ku do të mbështeteni, çfarë do të bëni që, nëse zgjidheni Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të mundësoni, pavarësisht afateve ligjore, vënien në funksionim të Inspektoriatit në një kohe sa më të pranueshme? Ku i shikoni problemet? Organet e tjera kanë pasur vështirësi kur janë ngritur, prandaj është më shumë pyetja.

Kandidati Sokol Stojani merr fjalën dhe përgjigjet se, për hir të së vërtetës, është shumë e vështirë. Nuk doja ta nisja nga vështirësitë e ta errësoj situatën. Personalisht preferoj që ti shikoj gjërat me optimizëm. Unë, duke i referuar ligjit që lë një hapësirë për një periudhë 6 mujore, do të përdor resurset që ka Prokuroria e Përgjithshme dhe Inspektoriatit i K.L.D, gjithmonë me magjistratët, për pjesën jo magjistrat. Natyrisht ligji të jep hapësirën që të paktën për një periudhë të shkurtër në bashkëpunim me DAP-in, të bëhet një strukturë minimale sa për ta vënë në funksion brenda një periudhë 6 mujore. Volumi i punës është i jashtëzakonshëm dhe do të dalin rregullore, akte normative që normojnë qoftë mënyrën se si do të funksionojnë Komiteti i Emërimeve dhe i Vlerësimit apo ai disiplinor, pastaj përcaktimi i kriterit dhe kushteve për rekrutimin e punonjësve në punë që duhen të jenë në standarte shumë të larta dhe jo gjithmonë janë në dorën e atij që e administron procesin. Kjo gjithmonë është në varësi të njerëzve të cilët aplikojnë. Standartet janë të larta dhe ligjvënësi e ka parashikuar që një pjesë të jenë magjistratë dhe një pjesë jo magjistratë. Por gjithsesi të jenë nga pjesa e kualifikuar, të kenë një Cv. Eksperienca ime është që ti shikoj gjërat me shumë optimizëm edhe ti zgjidhim hap pas hapi. Unë mendoj që tani, sigurisht që do të bëjmë ato marrëveshjet, qoftë me Prokurorinë e Përgjithshme, të shikojmë mundësinë e lëvizjes paralele të strukturave, meqënëse edhe ligji e lejon. Stoku është jashtëzakonisht i madh i ankesave që janë në Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë. Menjëherë mbas krijimit të saj do të ushtrojë funksionet, por stoku është jashtëzakonisht shumë i lartë dhe është qoftë në Prokurorinë e Përgjithme, qoftë atje. Unë mendoj që Prokuroria e Përgjithshme ka njerëz me shumë eksperiencë pavarësisht se është një numër shumë i vogël dhe do të duhet të dakortësohemi me Prokurorin e Përgjithshëm se edhe ai përgjysmohet staf. Por nisur nga eksperienca e tyre që është mbi 30 vjeçare mos gaboj, shumica e tyre them që përvoja bën që të jemi më racional dhe ti indentifikojmë problemet dhe gjëja e parë është identifikimi i tipologjive të ankesave, në mënyrë që ti jepet zgjidhje qoftë edhe nëpërmjet atyre “template-ve”. Nëse ka një tipologji, se ka gjëra që janë përtej, jashtë objektit të ankimit, natyrisht që qytetari kërkon përgjigje dhe duhet ti japësh përgjigje. Atë që kanë duhet ti japësh udhë, duhet ti japësh udhë, dhe kështu duhet marrë të trajtohet por thashë edhe njëherë që në bashkëpunim me DAP-in, edhe me vullnetin që ekziston sot nga shteti shqiptar, të paktën kur bëhet fjalë për mbështetjen nga

organeve të reja të qeverisjes dhe sistemit të drejtësisë, mund të kemi të paktën një strukturë minimale që do të rekrutohen natyrisht.

Do të zgjidhen edhe me komandim, me K.L.P-në, si me K.L.Gj, do të zgjidhet edhe me komandandime të tjera, përtej periudhës 6 mujore. Se varet çdo gjë edhe nga niveli i aplikuesve, nga rrethi i magjistratëve. Mund të ketë nga jashtë magjistratë por nga brenda magjistratë kërkohen të kenë standarte të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, meqënëse përfshihet në Inspektim edhe Gjykata e Lartë, si dhe anëtarët për shkeljet disiplinore, ne e kemi bashkëpunimin. Eksperienca ime ka sjellë një gjë që; në përgjithësi në Shqipëri institucionet funksionojnë me axhenda personale dhe tentojnë ti hedhin fajin njëri – tjetrit. Unë kam punuar në Prokurori, por pa një bashkëpunim të operatorve të sistemit qoftë edhe të burimeve të hapura të qytetarve apo të çdo lloj organizmi është e pamundur të vi produkti i kërkuar. Në vazhdimisht kemi thënë, ai e ka fajin, ato thonë këto e kanë fajin, e rëndësishme për qytetarin është produkti, cilësia e produktit. Ai nuk do të dijë se kush e ka fajin. Fajin le ta mbaj kush të dojë dhe le ta kontrollojnë organet që e kanë për detyrë. Ato duan që të vi cilësia. Kështu që është detyrë e organeve të ngarkuara me ligj që të operojnë, të bashkëpunojnë, të gjejnë pikat e kontaktit dhe të ndërveprojnë në mënyrë që të vi ai produkti i kërkuar. Jo rastësisht thashë që kur e thashë që, këto organe duhet të funksionojnë në sistem ajo është vetë, duhet të funksionojë në sistem si një makinë. Makina e ka sistemin e drejtimit, frenimit, sinjalizimit. Në qoftë se njëra nuk funksionon, nuk funksionojnë, makina nuk shtyn, nuk ecën para. Kështu që duhet të operojmë të gjitha hallkat e sistemit të cilat do të bëjnë të mundur atë me vullnetin e mirë për të arritur ato produktet e kërkuara, që të paktën të vihen në lëvizje. Kur thashë frenimin e rrëshqitjes, sistemi ka rrëshqit sepse dhe vonesa e ngritjes së organeve të reja dhe mos operimi i organeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka sjellë që secili ka axhendën e vetë, njerëz që e dinë fare mirë fatin e tyre në kuadër të rivlerësimit profesional dhe këto të Vetingut, po ngatërrojnë funksionet e tyre dhe po shofin axhendat personale me interesat. Jo gjithmonë të ligjshme. Në këtë drejtim, e para duhet ta frenosh dhe pastaj duhet ta mendosh çfarë do të ecim përpara. Me stafin që kemi janë të vogla por të verifikosh problematikat që gjatë kësaj periudhe, jo rastësisht thashë periudha tranzitore 2016 – 2018 se janë stok i identifikim nga 2 Inspektoriatet por që nuk avanconim dotë përpara, sepse është eskuziviteti i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të avacuar procedimin disiplinor, që kanë ngelur si stok, janë indentifikimi që ata kanë bërë, mund të jenë edhe të tjera që mund të sjellin intitucionet në dinamikë që ato do të kenë përparësi, flasim gjithmonë për atë që kanë axhenda personale jo.

Margarita Buhali merr fjalën dhe duke i uruar suksese në kandidim, shprhet se unë besoj gjithmonë që prokurorët janë ata që flasin më mirë pa letra sepse guxojnë dhe kanë një

eksperiencë të gjatë si përfaqësues. Ju e treguat pas pyetjes së kryetarit, u ndjetë më i lirshëm në prezantimin e asaj që juve e thatë me shkrim, por e bëtë më konkrete dhe më të prekshme. Kështu që një pjesë e atyre që mendoja t'ju pyesja ju e ezauruat. Megjithatë duke qenë që përfaqësoj një pjesë të mirë të kolegëve gjyqtarë që gjykojnë jo vetëm në çështjet penale, por gjykojnë edhe në çështje civile, ku problematika ndoshta e ankesave të qytetarve është pak më e madhe, besoj që është gjithmonë më e madhe në aspektin civil, do të doja mendimin tuaj, lidhur me aq eksperiencë që ju keni në aspektin proceduaril civil, në rast se keni, dhe si mendoni ta zgjidhni këtë pjesën tuaj, sepse jeni më shumë i fokusuar në aspektin procedural penal që nuk e vë në dyshim që e njihni shumë mirë?

Kandidati Sokol Stojani merr fjalën dhe përgjigjet se për hir të së vërtetës, shkeljet disiplinore janë njëlloj, si për gjyqtarët, si për prokurorët. Të parashikuara nga ligji nr.96/2016. Unë do të thoja se Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk mund ti hyj themelit të çështjes, nuk bëhet fjalë për themelin e çështjes, por bëhet fjalë për shkelje. Në aspekti procedural janë gjëra që kanë lidhje le të themi me aspektin të kontakteve që ka ajo, të mënyrës se si organizohen shortet, të mënyrës se si bëhen zëvendësimet e prokurorve dhe të gjyqtarve. Ne nuk i hyjmë themelit sepse sistemi që kemi zgjedhur është sistem vetëkorrektimi, me shkallë. Nëse ai këtë veprim e bëri të drejtë, e mori këtë provë korrekt apo nuk mori këtë provë korrekt, kjo është objekt shqyrtimi nga gjykatat më të larta. Nuk mund të jetë në formimin tim, kjo objekt i hetimit administrativ nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kështu në këtë aspekt nuk e shof që të jap përgjigje a është korrekt, natyrisht që mënyra sesi është konceptuar do të jenë 8 gjyqtar, 8 magjistratë që merren nga gjyqsori dhe nga prokuroria. Ka zgjidhje, nuk është se nuk janë. Por unë në formimin tim nuk është kjo, që të hyj në themelin e çështjes dhe të procedurës që garantojnë proces të rregullt ligjor. Procesin e rregullt e kam në funksion të procedimit administrativ, të hetimit administrativ, se sa të thelbit të vetë procesit. Nuk e di se sa i qartë. Nuk mund ti hyj themelit të çështjes për probleme të caktuara. Nëse kishte të drejtë gjyqtari apo jo, e ka sistemi i vetëkorrektimit. Unë thashë edhe njëherë puntoja fort tek ajo synimet apo fokusi që kishte vetë ligjvënësi edhe që është në formimin tim.

Unë nuk synoj ta kthej si qëllim në vetëvetë Inspektimin. Aty duhet të jetë një balancë midis nevojës për të hetuar dhe për të proceduar në qoftë se konstatohet realisht që ka shkelje dhe për të garantu pavarësin e gjyqtarit në ushtrimin e funksioneve të tij dhe gjykatës në përgjithësi sepse mund të ndodh që mund të ketë synime të tjera edhe përdor procese të tjera. Domethënë në inspektim përdor procese të tjera dhe në fakt mund ta indimidojë gjyqtarin për një proces tjetër. Unë nuk preferoj dhe e thashë edhe në fjalën time, unë preferoj e para, të jem proporcionale, e dyta të jetë e përshkallëzuar. Kjo është fryma e ligjit, kështu e preferoj, kam qejf dhe prandaj dhe

e theksojmë që duhet të jenë edhe këto, dhe unë them që deri më sot jemi bërë ndërkohë sektare për të njëjtën gjë dikush është ndëshku, dikush jo. Dhe të jemi realist, ti themi qartë gjërat kurse unë nuk e kam këtë, unë them që në formimin tim duhet që ai person i cili që ka bërë një shkelje të caktuar e para të jetë proporcionale dhe e dyta të jetë e përshkallëzuar duke filluar nga më e lehta deri tek më e rënda, në mënyrë që të bëhet edhe edukative. Të ketë një kulturë profesionalizmi dhe të edukohen që e para po bëre një shkelje do të ndërkohësh por nga ana tjetër nuk do të marri atë ekstrem për ti intimidu gjyqtarin në pavarësinë e tyre. Dhe kjo lloj edukate do të çoj në parandalimin e bërjeve të akteve ekstreme që godasin rëndë sistemin. Më mirë proporcional sesa të arrish tek rasti ekstrem. Nuk mund të shkosh tek rasti ekstrem. Të gjithë jemi njerëz, gjykimi është subjektiv, nuk kemi qenë perfekt dhe nuk jemi perfekt, thuhet që perfekti është vetëm zoti, kështu që të gjithë kemi bërë gabimin gjatë aktivitetit tonë por jemi përmirësues, jemi rrit, jemi pjekur gjatë gjithë këtyre viteve dhe në këtë kontekst them që përshkallëzimi që jep ligji do të jetë dhe fryma, eksperiencia ime ka këtë këndvështrim, ky është fokusi im, ky është formimi im, nuk di çfarë të them. Nuk e di sesa i qartë jam.

Margarita Buhali merr fjalën dhe shprehet se ishiti shumë i qartë. Vetëm një pyetje, që është më shumë shoqërore, duke u nisur nga aspekti i punës që keni bërë dhe fakti që shpesh ju jeni në dijeni që, ngaqë prokurori është gjithmonë iniciatori i hetimit dhe e ndjek shumë mirë çështjen, e prezanton deri në gjykatë, e ankimon, mund të ketë edhe momente që nuk ka qenë dakort me gjykatën dhe ka ndjekur rrugën ligjore siç është vepruar në përgjithësi. Unë do të doja thjesht tu bëja një pyetje sa mund ta ndani veten tuaj subjektivisht nga të qëniti prokuror kur nesër do tu paraqitet çështje për inspektimin e një gjyqtari që ka lidhje me çështjet penale ose ndoshta edhe një çështje që ju e njihni shumë mirë vetë se mund të keni qenë prokuror, ose mund të keni qenë edhe në këshillime, mendime siç kërkoheshin edhe paraprakisht në prokurori.

Sokol Stojani merr fjalën dhe përgjigjet se nuk e di tani ndoshta është edhe modesti e tepruar apo ta kalojmë modestin, në formimin tim po ti merrni të gjitha proceset, do të shofësh një gjuhë të kultivuar kurrë nuk mund të gësh fjalë të rënduara për palën në proces, se mund të jem edhe unë i gabuar. Se ne jemi palë në një proces, kurrë nuk ka ndiku gjendjet emocionale. Unë kam prezantuar sipas opinionit tim përpara një gjykate, kam kërku 1, 2, 3, duke qenë mundu që të jem rracional. Po të vesh re, unë, mund të jenë dosje voluminoze, mundohem të kap thelbin e problemeve dhe të trajtoj atë që mendoj që është relevante, është e rëndësishme. Tani eksperiencia në gjykatë ka sjellë që gjyqtarët edhe lodhen. Duhet të dish të kapësh thelbin, duhet të dish të heqësh vëmendjen e gjyqtarit për ato gjëra që paraqesin interes për të. Natyrisht edhe për procesin por që ato janë ndiku. Në këtë pikë unë nuk përfshihem emocionalisht, tani njerëz jemi nuk, të thush apsolutisht do të gënjej. Nuk ka njerëz, por unë nuk përfshihem emocionalisht me

gjqqtarin sesa e kam me faktin. Domethënë unë edhe në jetë, mund të jetë mos jetë në një proces gjyqsor por një fakt qoftë edhe i pa nxitur më bën përshtypje, lë impakt. Por kjo nuk do të thotë që ne përdorim autoritetin dhe ta abuzojmë me atë tjetrin. Unë në fakt me thënë të drejtën, kam punuar 10-11 vitet e fundit kam punu kontroll hetimi, përfaqësim çështje në Gjykatë të Lartë, inspektim, domethënë kjo është, unë këtë punë kam bërë. Domethënë është ideja që, pse e hodhe kandidaturën? Jo moj, unë e ndjej tek vetja ime, këtë punë kam bërë nuk di të bëj punë tjetër, nuk është se po ndryshoj shumë tek ato, dhe nuk besoj që. Kam qenë edhe anëtar i Këshillit të Lartë Prokurorisë dhe me thënë të drejtën mund të hapësh dhe procesverbalin e këshillit të prokurorisë kur kam qenë edhe aty kur kam kaluar nga Prokurori i Përgjithshëm, do të shofësh që ke gjithmonë votën time kundër për një njeri që unë nuk kam qenë në funksione drejtuese mendon që ti e ke pjesë të stafit, aty ku unë nuk kam bindjen time e kam dhënë. Kjo nuk do të thotë që bindja ime është gjithçka. Unë sjam askush. Unë kam respekt për veten time. Mjafton të hapni procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe do të shofësh shumë transferime, lëvizje apo ngritje në detyrë kur kamë qenë anëtar këshilli nuk kam qenë dakort. Ose kam dalë në minorancë kur e kam vlerësuar që duhet të shkarkohesh dhe po merreshin në mbrojtje, por kjo nuk do të thotë që mendimi im është më i miri i mundshëm, mund të kem qenë në ekstrem sepse më ka lënë impakt negativ. Ne funksionojmë, për sa kohë që gjykimi është nga njerëzit, edhe gabimi është njerëzor. Gjithë mund të biem pre e gabimeve, por interesante do të jetë gjë të mos përsëritet dy herë një gabim dhe njerëzit të rriten dhe të pihen. Ne jemi pjekur në saj të gabimeve. Gjithë investimi i shtetit kur kemi dalë në fillim se atëherë nuk kishim magistraturë. Ne kur kemi dalë në fillim nuk kemi ditur të bëjmë një vendimmarrje të pandehurit. Natyrisht në asistencën e më të pjekurve, ecëm hap pas hapi, kemi punuar non stop, ma beso. Gati me 3 orë në ditë gjumë. Sidomos vitet e fundit na është prishë gjumi. Po dhe vitet e para kam punu nga 95' deri në 2002 me një kohëzgjatje jashtë zakonisht të madhe pune. Pra, unë nuk kam qenë 8 orë në punë. Unë kam punu me një eksperiencë është 26 vjeçare, po të them kam eksperiencën e një njeriu që ka 50 vjet punë madje, sepse unë kam ndjenjur gjatë gjithë kohës në terren. Në punë, mbikqyrje, kontroll, administrim, menaxhim, sipas funksioneve. Nuk kam përtuar dhe më tepër më kanë marrë për punë. Karriera ime po ta vësh re sesi është ngritur, e kam marrë në sajë të punës. Por edhe kur shkova në Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurori i Përgjithshëm nuk më bëri njeri që më njipte, mua më morën për punë dhe në saj të punës ashtu erdhën rrethanat që u dorëhoq dikush, dikush duhet ta merrte përgjegjësinë dhe unë e kam bezdi një punë e lënë përgjysëm është më mirë sesa një punë e pafilluar fare. O çojë deri në fund, thuaj mirë keq të jetë ashtu siç e gjykon si e mendon. Kështu jam rrit, kështu jam formu, ky është formimi im, nuk..respektoj realisht bindjen time. Në të gjitha proceset që kam bërë kurr nuk jam tërhequr,

them bile e konsideroj të papranueshme që opinionet personale në analiza, takime, sidomos hetimesh është shumë e rëndë por edhe në fazën e gjykimit në kolegji, në dhomë këshillimi janë të papranushme dalin jashtë. Është jo etike, është njëlloj sikur ta nxjerrësh tjetrin që ta vrasim, kështu që ne kemi bërë punën. Unë ndihem komod. Sot, kandidatura ime është hedhur edhe në respekt të këtij procesi. Unë, se po them unë disa herë dhe po tejkaloj modestinë, por kam pasur disa mundësi për të qenë në pozita drejtuese. Më janë ofruar pozita drejtuese edhe mbasi ika drejtor hetimi, por natyrisht kam qene kur nuk kam besuar në një projekt nuk kam pasur përse të merrem me debate. Sepse ndajmë filozofi të ndryshme, edhe tani mu dha prapë një mundësi dhe ika vetë sepse kishim këndvështrime të ndryshme. Kjo nuk do të thotë që unë isha më i miri. Unë kisha një këndvështrim. Në qoftë se dikush tjetër është më i madh se unë ai ka responstabilitetin, ai ka përgjegjësinë përpara Parlamentit të thotë lidhur me mbarë-vatjen. Unë do ti jap mundësinë që ta bëj. Po unë vetë nuk e bëj dot diçka që nuk më bind.

Eriol Roshi merr fjalën dhe shprehet se siç e thatë dhe ju dhe siç është kuptuar nga të gjithë që punojnë në sistem dhe kanë mbetur në sistem, stoku i ankesave është jashtëzakonisht i lartë, grumbulluar si në organet e prokurorisë dhe gjithashtu edhe në KLGJ. Pasi të konstituohet struktura e Inspektorëve, ju mendoni se do të kenë përparësi trajtimi i ankesave individuale apo ato që quheshin dikur inspektime tematike apo një kombinim ndoshta i këtyre të dyjave?.

Sokol Stojani merr fjalën dhe duk e falënderuar për pyetjen dhe shprehet se është pyetje shumë me vend, më duket sikur ke punuar një jetë me inspektim. Gjërat duhen të jenë të kombinuara, unë vura disa pika, unë mund të kem më shumë, mund të rrimë pa gjumë gjithë natën, të jap difekte që i identifikoj unë tek sistemi. Unë i vendosa aty në mënyrë përmbledhëse, lë të themi. Ajo që është bërë problem tek këto institucione janë mënyra e shortimit. Heqjet dorë të prokurorëve, në mënyrë të pajustificuar. Fjala bie ta kthejmë më konkrete. Të pandehur të caktuar me rrezikshmëri shumë të lartë, çfarë bëjnë, bëjnë kërkesa ndaj gjyqtarve si ti përjashtojmë. Bëjnë kallëzim lart dhe poshtë, për të përjashtuar ata dhe për të paracaktuar gjyqtar të caktuar për të nxjerrë përfitime ligjore të padrejtë. Ka ndodh, jo njëherë. Kështu që, janë ca tema që do ti prekësh të kombinuara, qoftë institucionale, qoftë edhe ato raste individuale. Pra, çdo rregull ka një përjashtim, së thashë, do ndjek proporcionalitetin por është po aq proporcional për ata njerëz që kanë axhendën individuale, që jetojnë si për ditë të fundit. E dinë që do të ikin edhe bëjnë çtë bëjnë.

Kështu që tema të përgjithshme mund të gjejmë pa fund. Prandaj thashë te stoku do shofim se ka Avokati i Shtetit po aq e dhimshme është se ka gjyqtarë dhe prokurorë që jo gjithmonë e njoftojnë. Por ky është problem shumë i madh sepse shteti nuk ka atë syrin e veshin e vet për të kërkuar gjërat me një padi civile. Ne jse kjo nuk bëhet me krahasime. Ka zëvendësime,

kalimi nga një seksion në tjetrin që përdoren në mënyrë parciale sektare, nuk kam të kam qejf unë e në varësi të humorit të drejtuesit të kaloj nga një sektor të tjetri. Kam eksperiencat e mia se kam qenë Drejtor i Burimeve Njerëzore 10-15 vjet. Nëse trajnojmë dikë dhe e çoj për ta trajnuar për një periudhë relativisht të gjatë kohe, natyrisht para se ta çojmë për ta trajnuar për gjëra afatgjatë unë kam parë edhe paraprakisht edhe background-in e tij, ca të dhëna një minivetting të vogël që e bëjmë me shërbimet, ILDKPKI etj. dhe e shohim pak a shumë me një probabilitet 70% që ti e kalon. Ndërkohë që investoj në një fushë të caktuar ai këtej ka qefmbetje dhe mund të kaloj në një sektor tjetër dhe kjo është e pa pranueshme si ligji dhe fryma e ligjit është që prokurorët duhet të vijnë mbi bazë të shortit. Mund të ketë rregullime që për shkak të ngarkesës njëri nuk mund të mbajë 100 çështje atëhere drejtuesi ndërhyr por duhet të jetë e motivuar dhe e rregulluar. Pra kapa disa gjëra tematike që po më vijnë për momentin.

Fatjona Memçaj merr fjalën dhe shprehet se në fakt do ta falenderoja sepse prokurorët nuk është se marrim shumë inisiativa konkurrimi. Ndoshta dhe jemi mesuar me sistemin e moskonkurimit, kështu që vetë unë e vlerësoj shumë faktin që ai është këtu si një prokuror se gjithmonë ngelemi në atë që sistemin e njohim nga këndvështrimi penal jo nga këndvështrimi civil dhe administrativ siç e kanë gjyqtarët dhe e vlerësoj shumë që një prokuror erdhi në këtë garë dhe e demonstroj njohjen e thellë që ka për sistemin. Faleminderit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, meqenëse nuk ka më pyetje, e falënderon kandidatin për shpjegimet dhe përgjigjet e pyetje dhe i njofton mbarimin e intervistës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, informon mbledhjen se do të kalohet në pikën e fundit të rendit të ditës, kryerjen e shortit për vendin vakant, Mund ta bëjmë edhe duke e mbyllur mbledhjen dhe zhvillohet shorti. Znj. Memçaj nuk merr pjesë për shkak se është e përjashtuar nga nga diskutimet dhe procedurat në këtë vakance për arsye që e njohim. Kështu që mbledhjen mund ta mbyllim dhe të fillojmë procedurën e shortit

Margarita Buhali kërkon fjalën dhe shprehet se meqenëse fillojmë edhe procesin e vlerësimit dhe pikëzimit, duke qenë se Avokati i Popullit në shkresën që dërgoi kishte mendime për dokumentacionin edhe gjatë kohës që ne jemi të mbledhur për efekt të pikëzimit, ndoshta unë do të doja si relatore që ne të caktojmë një datë që jo të diskutojmë sepse ne jemi në dhomë këshillimi ku do të caktojmë pikët, por që mjafton një datë paraprakisht kur mund të jemi të mbledhur për të dhënë pikët që, në qoftë se Avokati i Popullit ka mendimin e vet, gjatë ë saj kohe mund të nisi gjithçka që ajo mendon lidhur me kandidaturat për procesin, për gjithçka tjetër që të jetë në vëmendjen tonë. Pra në rast se do kemi një mbledhje ku secili nga ne do të japi pikët për kandidat do të dihet edhe nga Avokati i Popullit ose Presidenti që në këtë datë pritët që Këshilli të nxjerri pikët për kandidatët. Pastaj është tjetër gjë, patjetër ne do kemi mbledhje se do bëjmë

pjesën e listave ose gjithçka tjetër, gjithmone per ti dhene mundesi Avokatit te Popullit që në kuadër të atyre parashtrësive që ne na ka bërë paraprakisht, në qoftë se do të japi ndonjë mendim për gjithçka që mendon e që ndoshta mund të jete ne fokusin tone, për vlerësim apo jo është tjetër gjë se Avokati i Popullit e di shumë mirë pjesën e rolit të tij. Por roli i tij është edhe të na vejë në dijeni për gjithçka tjetër që mund të ndikojë në vlerësimin e kandidatit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani shtron pyetjen për efekt të vlerësimit sepse e kemi bërë verifikimin?

Margarita Buhali merr fjalën dhe përgjigjet se të jetë për efekt të vlerësimit jo për efekt të verifikimit të kandidatëve.

Erinda Ballanca krkon fjalën dhe shprehet se unë jam shumë dakort. Ne jemi perpjekur që ta paraqesim me shkrim, kuptohet në një problematikë shumë të madhe për sa i përket kohës sepse realisht e kemi pasur shumë të vështirë që të shikojmë ato materiale që na kanë ardhur në një kohë aq të shkurtër. Dhe kjo nuk është më një rast, kjo është gjithmonë. Prandaj unë vërtetë çdo rast më është dashur që të punoj me ore të gjata dhe të mbajmë njerëzit të punojnë me orë se na vijnë materiale që është e pamundur për ti trajtuar brenda një afati kohor të caktuar dhe unë nuk e di ndoshta ju i keni marrë përpara meje, por unë personalisht nuk kam mundesi fizike të shikoj të gjitha ato dokumenta, ashtu siç besoj duhet të shikoni edhe ju për të bërë vlerësimin përkatës. Ndoshta mund të jetë çështje interpretimi por e shikoj të vështirë që të bëjmë një vlerësim tërësor pa pasur një listë dokumentesh që na vjen në dispozicion që këto janë dokumentat dhe pa pasur kohën e nevojshme për ta bërë. E them këtë që institucioni i Avokatit të Popullit dhe këtë e them me shumë shqetësim, ka zhvilluar një proces që sot po anatemohet jo pak nga personat e tretë, procedurën e verifikimit paraprak të personave që kanë vajtur në organet e vetë dhe atëherë me vullnet shumë të madh nderkombëtarë, me miratim, me rregullore, domethënë ka pasur edhe fleta lavdërimi, një pesë a gjashtë, i janë dhënë për Avokatin e Popullit në atë kohë për procedurën që ka zhvilluar për efekt të afatit kohor etj., por e vërteta është që sot ky proces rezulton me shumë probleme dhe komentet janë të këtij lloji, të nivelit të dokumentacionit të llojit sepse nuk e di, disa gjëra mundet të na shpëtojnë nga fakti që nuk e kemi mundësinë dhe kohën e duhur për të parë të gjitha dokumentat. Prandaj e ngre këto shqetësime, që gjithë kjo punë të mos na rezultojë në një vlerësim, ndoshta edhe padashjen tonë, të padukur. Nuk dua që të dukem sikur dua që ta pengoj procesin në asnjë rast sepse ne kemi qene prezent dhe jemi munduar të japim informacione maksimalisht për sa i përket dedikimit në këtë proces por mendoj që është e rëndësishme për çdo proces të jetë koha e dukur dhe të jetë dokumentat e dukura. Ka një lloj përgjegjësie që këto dokumente unë e kam parë unë s'mund të jap të themi opinion mbi një dosje që ka pjesë të dokumentit që unë nuk e di që i kam parë dhe s'ka gjurmë

nëse unë e kam parë apo si kam parë. Kjo nuk më duket të them të vërtetën, nuk më duket e nivelit të seriozitetit dhe të luajalitetit që institucionet tona duhet të kenë me njëri – tjetrin.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani merr fjalën dhe shprehet se e mendojmë këtë gjë. Atëherë kalojmë te procedura e shortimit.

Në këtë pjesë të mbledhjes realizohen veprimet e shortit për caktimin e anëtarit të Këshillit relator për vendin vakant, vakancë e parakohshme, në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi në datës 21. 08.2019

Procesverbali i hedhjes së shortit i bashkëlidhet këtij procesverbal të mbledhjes së Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani pas realizimit të procedurës së shortit, deklaron mbylljen e mbledhjes.

MBYLLET MBLEDHJA NË ORËN 18.50

Sekretare

Kryetar

Ermelinda Kadiu

Ardian Dvorani

Redjona Myrtja